

**RAPORTI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE
DHE PANELI I KËSHILLËTARËVE TË RINJË**

*MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NËPËR
SHKOLLA*



**RAPORTI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE DHE PANELI I
KËSHILLËTARËVE TË RINJ**

***MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA
NËPËR SHKOLLA***

Botues:

Mbrojtësi i qytetarëve Deligradska 16, 11000 Beograd www.zastitnik.rs

Për botuesin:

Saša Janković

Autorët:

Snežana Nešić Nataša Jović

Shtypi:

Interprint

qarkullimi: 250

Raporti i Mbrojtësit të qytetarëve është i bazuar në rezultatet e kërkimit në 72 shkolla fillore dhe të mesme në Serbi, të kryera nga anëtarët e Panelit të këshilltarëve të rinj të Mbrojtësit të qytetarëve. I falënderojmë për angazhimin, përkushtimin dhe kontributin në përmirësimin e gjendjes dhe mbrojtjen e të drejtave të bashkëmoshatarëve të tyre: Andrijana nga Beogradi, Andria nga Nishi, Bilana nga Novi Sadi, Bilana nga Beogradi, Veljko nga Subotica, Vladimir nga Sivaçi, Vukani nga Pancevo, Emilija nga Bella Cërka, Iliana nga Sremska Kamenica, Jovani nga Piroti, Kristijani nga Nishi, Kristina nga Curuga, Llavi nga Beogradi, Luki nga Stojnik, Maria nga Medvegja, Milani nga Kraljevo, Milica nga Nishi, Milica nga Palanka e Smederevës, Miljana nga Piroti, Mihajli nga Beogradi, Natasha nga Duciç, Naxhi nga Uzice, Nevena nga Kraljevo, Nemanja nga Pozharevci, Nemanja nga Lucana, Nikolla nga Majdanpeku, Nikolla nga Subotica, Nini nga Beogradi, Predrag nga Babušnica dhe Sandra nga Brasina.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NËPËR SHKOLLA	10
MANDATI DHE AKTIVITETET E MBROJTËSIT TË QYTETARËVE NË PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS DHE PËRMIRËSIMIN E MBROJTJES SË FËMIJËVE NGA DHUNA	11
Mendimet, rekomandimet, këshillat e Mbrojtësit të qytetarëve.....	12
Paneli i këshilltarëve të rinj.....	13
HULUMTIMI DHE RAPORTI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE DHE PANELIT TË KËSHILLTARËVE TË RINJ	15
Hulumtimi i panelit të këshilltarëve të rinj.....	15
Qëllimet dhe supozimet e kërkimeve.....	15
Procedura metodologjike.....	16
Mostra e hulumtimit.....	17
Rezultatet e hulumtimit.....	18
Përhapja e dhunës në shkolla.....	19
Dhuna në mesin e nxënësve.....	19
Dhuna e mësuesit ndaj nxënësve.....	21
Masat parandaluese të dhunës në shkolla dhe pjesëmarrja e nxënësve në këto masa.....	22
Ekipi për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja	29
Njoftimi i nxënësve për formimin e ekipit.....	29
Njoftimi i nxënësve se kush janë anëtarët e ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, dhe mospërfillja dhe si mund t'i drejtohen.....	30
Veprimi i shkollës në rastet e dhunës.....	38
PROBLEMET PRIORITARE NË PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA, ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA NË SHKOLLA	41
REKOMANDIME	45
SHTOJCA: KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA, ABUZIMI DHE MOSPËRFILLJA NË SHKOLLA	49
Konventa mbi të drejtat e fëmijëve me protokoll zgjedhor.....	49
Plani Kombëtar i Veprimit për Fëmijë.....	51
Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.....	51
Ligji për krijimin e sistemit të arsimimit dhe edukimit.....	54
Rregullorja e protokollit të trajtimit në institucionet përgjegjëse ndaj dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes.....	60
Protokolli i Përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe mospërfillja.....	67
Protokolli i veçantë për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në institucionet arsimore.....	

HYRJE

Në shkollë, si një institucion shoqëror, me ligj përcaktohen qëllimet, objektivat dhe mënyra e funksionimit të saj, struktura dhe organizimi i saj, por edhe hartohen figurat e rëndësishme, rolet, format e sjelljeve dhe marrëdhëniet ekzistuese në familje dhe shoqëri. Përhapja e dhunës është një lloj i testit të përmbushjes së obligimit që e ka familja, shteti dhe shoqëria në rritjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijës dhe është një tregues se si ata i kryejnë detyrat e tyre në krijimin e kushteve të sigurta për mbijetesën, jetën dhe zhvillimin e fëmijëve, në rregullimin e sjelljes dhe zhvillimit të pavarësisë, vetë-respektit dhe identitetit të tij.

Është e vështirë për të dhënë informacion të saktë mbi shkallët dhe format e dhunës që sot fëmijët në Republikën e Serbisë janë duke e vuajtur, duke qenë se nuk ka një sistem uniform për regjistrimin dhe monitorimin e këtij fenomeni. Megjithatë, rezultatet e hulumtimeve të shumta, të cilat në dekadën e fundit janë bërë nga institucionet me sektorë të ndryshëm dhe nga organizatat jo-qeveritare, tregojnë një trend në rritje të dhunës në familje, dhe sidomos dhunë mes fëmijëve dhe të rinjve të moshës së njëjtë. Të dhënat aktuale konfirmojnë gjithashtu se rrethanat negative sociale në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli, fëmijët në Republikën e Serbisë janë të ekspozuar ndaj rrezikut më të madh të dhunës.

Në institucionet arsimore, sipas informacionit në dispozicion, janë të pranishme format dhe llojet e ndryshme të dhunës. Fëmijët janë të ekspozuar ndaj dhunës nga moshatarët e tyre, por edhe nga më të rriturit. Çdo ditë ballafaqohemi me të dhënat nga media se si shkollat janë të ekspozuar ndaj ndikimit negativ të shumë faktorëve mjedisorë që ndikojnë në sigurinë dhe zhvillimin e duhur të fëmijëve (afërsia e kafe barëve, stacioneve të autobusëve dhe trenit, parqet dëfryese, tregjeve, kazinove, bastoreve, lojërave të ndryshme, etj).

Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme të kryera në shkollat fillore dhe të mesme tregojnë se format më të shpeshta të dhunës janë në formë verbale, por edhe format e tjera të dhunës psikologjike (fyerjet dhe talljet - 40%, thashethemet, përhapja e gënjeshtreve, izolimi social - 38%, kërcënimet dhe frikësimet - 21%), më pas konfiskimi dhe shkatërrimi i formave të ndryshme të pronësisë, forma të ndryshme të detyrimit, shantazh, kërcënime me armë dhe ngacmimi seksual, dhe madje 70% e nxënësve të anketuar kanë pasur mundësi të shohin përleshjet dhe lëndimet me njëri-tjetrin¹.

¹ Hulumtimi në Shkollë më të vogël mbi nxënësit e shkollave të Beogradit, Savović, B. (2003). Agresiviteti i nxënësve në shkollë, Fakulteti Filozofik, Beograd

Zhvillimi i teknologjisë moderne të komunikimit ka çuar në shfaqjen e një forme të re të dhunës me keqpërdorimin e teknologjive të informimit midis dhe kundër fëmijëve (dhuna elektronike): mesazhet e dërguar me e-mail, SMS, MMS, nëpërmjet uebfaqes, përmes forumeve, rrjeteve sociale, etj.

Ka një sasi të konsiderueshme të të dhënave që kontribuojnë në përshtypjen se aktet e dhunës janë gjithnjë e më brutale dhe në to marrin pjesë fëmijët gjithnjë e më të vegjël. Të dhënat e fituara në hulumtimin e filluar në vitin 2005 nga UNICEF në bashkëpunim me një numër të madh të institucioneve në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë, në kuadër të programit "shkolla pa dhunë", në të cilin deri në mesin e vitit 2009 kanë marrë pjesë nxënësit nga klasa 3 deri në klasën 8 dhe të punësuar nga 165 shkolla fillore, tregojnë për pranimin e sjelljes së dhunshme në shkolla, dhe është e prirur si nga nxënësit më të vjetër ashtu edhe nga më të rinj, dhe si nga djem ashtu edhe nga vajza. Lidhur me atmosferën e zgjeruar të dhunës në shkollë tregojnë edhe informata e këtij hulumtimi për faktin e përhapur të ndjenjës së pasigurisë, sepse çdo nxënës i katërt (27%) ka thënë se në shkollën e tij ka nxënësit që kanë frikë, sepse mund ta keqtrajtojnë².

Gjatë shkollimit 23% e nxënësve, një ose më shumë herë kanë përjetuar që ndonjëri prej mësuesve të tallet me ta, t'i fyej ose t'i godas³. Në një hulumtim të kryer në 1,289 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në Beograd, Novi Sad dhe Nish, janë fituar të dhënat për përhapjen e konsiderueshme të ndëshkimit fizik në shkolla, dhe madje 21% e nxënësve të shkollës fillore janë ankuar se mësuesit i ndëshkojnë fizikisht, dhe nga dhuna fizike janë ankuar 4% e nxënësve të shkollës së mesme⁴. Anketimi në kuadër të programit "shkolla pa dhunë", ka treguar për përhapjen e përafërt të dhunës së mësuesve ndaj fëmijëve: 25% e nxënësve nga klasa 5 deri në 8 kanë thënë se në 2-3 muajt e fundit kanë përjetuar fyerje nga mësuesit, 15% që mësuesi i ka goditur, 8.5% që mësuesi i ka kërcënuar⁵.

Mënyra më të zakonshme e reagimit të fëmijëve ndaj dhunës nga bashkëmoshatarët e tyre, është shmangia nga bashkëmoshatarët të cilët sillen dhunshëm, kthimi në masë të njëjtë, parandalimi me shaka dhe biseda. Ndihmë nga të rriturit kërkojnë 30% dhe bashkëmoshatarët 25% e fëmijëve. Shumë shqetësuese janë të dhënat që tregojnë se 44% e nxënësve nuk bëjnë asgjë dhe qëndrojnë pasiv në situata të dhunës ndaj tyre⁶.

Hulumtimi pjesëmarrës i fëmijëve dhe të rinjve për abuzim, i realizuar në bashkëpunim të UNICEF-it, Institutit të Shëndetit Mendor, dhe OJQ Damad, ka treguar se fëmijët hezitojnë që t'i drejtohen prindërve dhe shërbimeve përkatëse sepse nuk presin që dikush do të ju besoj. Fëmijët kanë shprehur pritjet e tyre nga prindërit që t'i kushtojnë më shumë vëmendje, t'i dëgjojnë dhe t'i zgjidhin problemet e tyre me fjalë, e jo me përleshjet. Gjithashtu, është paraqitur propozimi që

² Popadiq, D. (2009), Dhuna në shkolla, Instituti i Psikologjisë, Beograd

³ Strategjia Kombëtare për Fëmijët

⁴ Savovic, B. (2001), Qëndrimet e nxënësve ndaj problemeve disiplinore në shkollat fillore dhe të mesme, Punimet e Institutit të Kërkimeve Arsimore, 33, 408-416.

⁵ Popadiq, D (2009), Dhuna në shkolla, Instituti i Psikologjisë, Beograd

⁶ Strategjia Kombëtare për Fëmijët

bashkëmoshatarët do të mund të përfshihen në procesin e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi si këshilltarë të moshatarëve⁷.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se shumica e nxënësve (75%) kanë miq në shkollë dhe e shohin shkollën si një vend miqësor. Mësimdhënësit besojnë se në uljen e dhunës në shkollë më së shumti mund të kontribuojë bashkëpunimi më i mirë me prindërit (69%) dhe zhvillimi i aftësive të komunikimit (51%)⁸.

Mbetet, gjithashtu, e panjohur se me zhvendosjen e fokusit të publikut zyrtar dhe të përgjithshëm ndaj ngjarjeve në shkollë, sa ka kontribuar në rritje reale të dhunës, dhe sa është rritur vetëdija për nevojën e mbrojtjes së fëmijëve të cilët janë të ekspozuar ndaj dhunës nga bashkëmoshatarët dhe/ose nga të rriturit në shkollë. Pavarësisht nëse tani evidentohen rastet që më parë nuk do të ishin vënë re, ose ka ardhur deri te ndërgjegjësimi i rritur i shoqërisë për këtë lloj të kërcënimit ndaj fëmijëve në shkollë, mbetet detyra e shtetit dhe obligimi i shkollës që sigurojë kujdesin e nevojshëm për fëmijët, si edhe pyetja nëse shteti dhe shkollat i kanë marrë të gjitha masat në kuadër të autoritetit të tyre për të reduktuar, kontrolluar dhe çrënjosur dhunën.

⁷ UNICEF (2005), Shfaqjet dhe mendimet e fëmijëve mbi shpërdorim, hulumtimi cilësor në shtatë komuna me fëmijët dhe të rinjtë e moshës 10-19 vjet, Beograd

⁸ Strategjia Kombëtare për Fëmijët

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NËPËR SHKOLLA

Duke vepruar në përputhje me angazhimet e ndërmarra, Republika e Serbisë e ka rregulluar në mënyrë legislative fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në institucionet arsimore si dhe e ka harmonizuar me normat dhe standardet ndërkombëtare (për më shumë detaje rreth kornizës ligjore në aneksin e këtij raporti).

Miratimi i Ligjit mbi bazës së sistemit të arsimit dhe edukimit (viti 2009), protokollit të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në institucionet arsimore (viti 2007) dhe rregullorja e protokollit të trajtimit në institucionet në përgjigje ndaj dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes (viti 2010), dhe më detajisht dhe konkretisht janë rregulluar aktivitetet dhe janë definuar procedurat për parandalimin dhe ndërhyrjes, të cilat institucionet arsimore janë të obliguar që të ndërmarrin me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna. Me këto rregullore, gjithashtu, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe rolet e të gjithëve të përfshirë në jetën dhe punën e institucioneve arsimore.

Në mënyrë që shkolla të mund përmbushë qëllimet e saj kryesore për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve, ajo jo vetëm që duhet të ketë mekanizma për trajtimin e rasteve të dhunës, por edhe mënyrën se si të përmbush rolin e saj të rëndësishëm në parandalimin e abuzimit dhe mospërfilljes të fëmijëve. Si pjesë e aktiviteteve të saj parandaluese, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në fillim të vitit 2009, ka miratuar kornizën e planit të veprimit për parandalimin e dhunës në institucionet arsimore.

Në sektorin e arsimit dhe edukimit janë iniciuar programe të ndryshme parandaluese që synojnë përmirësimin e cilësisë së komunikimit, zhvillimin e tolerancës ndaj diversitetit, reduktimin e dhunës dhe zgjidhjen e konfliktit në mënyrë konstruktive. Në katalogun programit të përsosjes profesionale të të punësuarve të arsimit për vitin shkollor 2007/2008, të cilin e ka bërë Instituti për avancimin e arsimit dhe edukimit, janë më shumë se 20 programe të akredituara që janë në funksion të zhvillimit të komunikimit jo të dhunshëm, tolerancës në diversitet dhe mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi, mospërfillja dhe dhuna. Në zhvillimin e tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm në shkollat fillore dhe të mesme ka kontribuar edhe aplikimi i lëndës zgjedhore të edukimit qytetar, si dhe programi "shkolla pa dhunë", të realizuar nga UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Shumica e programeve që synojnë përmirësimin e sigurisë së fëmijëve në shkolla, realizohen me bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (polici i shkollës, për shembull).

Së bashku me përditësimin e legjislacionit vendor dhe përshtatja e tij me normat dhe standardet ndërkombëtare, pas vitit 2000, janë krijuar mekanizmat e shumta institucionale të reja dhe mekanizmat ekzistuese të zgjeruara për mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar, si dhe synimi i përgjithshëm strategjik: që për të gjithë fëmijët pa dallime, t'i sigurojë rritje në një mjedis të sigurt nga çdo lloj dhune, në të cilin respektohen identiteti dhe dinjiteti i fëmijës, respektohen nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të fëmijës dhe i mundëson fëmijës zhvillimin e tolerancës dhe përdorimin e formave jo të dhunshme të komunikimit.

Institucioni i ombudsmanit, si një nga mekanizmat kombëtare, që merret me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, është e themeluar në Republikën e Serbisë në vitin 2005, me miratimin e Ligjit për Mbrojtësin e qytetarëve. Me Kushtetutën dhe Ligjin për Mbrojtësin e qytetarëve⁹ është formuar Mbrojtësi i qytetarëve si një organ shtetëror i pavarur, i cili i mbron dhe promovon respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave, dhe një nga zëvendësit e tij është përgjegjës për fushën e të drejtave të fëmijëve.

MANDATI DHE AKTIVITETET E MBROJTËSIT TË QYTETARËVE NË PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS DHE PËRMIRËSIMIN E MBROJTJES SË FËMIJËVE NGA DHUNA, ABUZIMI DHE MOSPËRFILLJA

Përveç autoritetit që të propozojë rregulloret e reja dhe të ndryshojë rregulloret ekzistuese, si dhe kompetencave që me këshilla dhe dhënie të mendimeve e promovon punën e organit administrativ, Mbrojtësi i qytetarëve, duke vepruar në bazë të ankesave të qytetarëve ose me nismën e vet, kontrollon nëse organet e administratës shtetërore, organet dhe organizatat e tjera, kompanitë dhe institucionet, të cilëve iu është besuar autoriteti publik, duke vepruar në pajtim me ligjet dhe rregulloret tjera të Republikës së Serbisë dhe në parimet e qeverisjes së mirë.

OPINIONET, REKOMANDIMET, DHE KËSHILLAT E MBROJTËSIT TË QYTETARËVE

Duke kontrolluar funksionimin e organeve dhe institucioneve dhe me identifikimin e mangësive në punën e tyre në lidhje me masat parandaluese dhe ndërhyrëse për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, por edhe dështimi për të siguruar parakushtet themelore për qasje të duhur dhe të plotë ndaj dhunës në shkolla, Mbrojtësi i qytetarëve ka dërguar mendimet dhe rekomandimet drejt institucionit të arsimit dhe administratës publike të cilave kompetenca shtrihet në fushën e arsimit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dhunës në shkolla dhe rritjen e kompetencave të shkollave dhe punonjësve në luftë kundër mospërfilljes të fëmijëve:

- rekomandim Ministrisë së arsimit dhe shkencës për të marrë masa për të siguruar një numër adekuat të punëtorëve profesional (psikologë, edukatorë, punonjës socialë dhe ekspertë në fushën e edukimit special), një përputhje jo vetëm me numrin e nxënësve, por edhe me nevojat reale dhe specifike të identifikuara të nxënësve në çdo shkollë;
- rekomandim shkollës për të edukuar ekipin për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja, dhe përbërjen e ekipit dhe kompetencat e tij t'i akordojë me qëllimin e ekzistencës së tij;
- rekomandim shkollës që në mënyrën e duhur dhe të plotë të shqyrtojë dhe vlerësojë çdo dyshim apo njohuri të dhunës ndaj një nxënësi;

⁹ Gazeta Zyrtare e RS ", nr. 79/2005 dhe 54/2007

- rekomandim shkollës që nxënësit, personeli dhe prindërit të jenë të informuar në mënyrë adekuate në lidhje me ekzistencën e ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja, anëtarëve të ekipit dhe aktivitetet e tij;
- rekomandim shkollës për të krijuar bashkëpunim të ngushtë dhe të plotë me të gjitha organet dhe institucionet (organin e kujdestarisë, policinë, shërbimet shëndetësor, autoritetet gjyqësore) për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për problemin e dhunës dhe zgjerimin e kompetencave të shkollës me kompetencat e këtyre organeve;
- rekomandim organit shtetëror përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit që me paraqitjet e dhunës të veprojë në mënyrë efikase dhe të menjëhershme, dhe në procesin e udhëhequr të përcaktojë plotësisht të gjitha faktet¹⁰.

Rekomandimet dhe mendimet janë rezultat i procedurave të kontrollit të zbatuara për ligjshmërinë dhe rregullsinë e punës së organit dhe institucionit si dhe lëshimet dhe dështimet e tyre, që Mbrojtësi i qytetarëve i ka përcaktuar në këto procedura¹¹.

PANELI I KËSHILLËDHËNËSVE TË RINJ TË MBROJTËSIT TË QYTETARËVE

Duke punuar për të përmirësuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht me qëllim të promovimit të të drejtave në pjesëmarrje dhe krijimin e kushteve për t'u dëgjuar zëri i fëmijëve dhe të rinjve, si dhe publiku i përgjithshëm dhe zyrtar të njoftohen me pikëpamjet dhe mendimet e tyre mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta, Mbrojtësi i qytetarëve e ka nisur një iniciativë për të formuar një panel të këshilltarëve të rinj (në tekstin e mëtejme Paneli), si një formë e pjesëmarrjes së vazhdueshme të fëmijëve dhe të rinjve në këto institucione.

Objektivat kryesore të Panelit janë:

- promovimin e të drejtave të fëmijës për të shprehur mendimet dhe të marrin pjesë në vendimet që janë të rëndësishme për fëmijët dhe që kanë të bëjnë me ta;
- krijimi i kushteve që fëmijët me të vërtetë të bëhet subjekt i të drejtave dhe pranimi i fëmijëve si partnerë të plotë në aktivitetet për të përmirësuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre;
- fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për përfshirjen sociale dhe ndërmarrja e rolit aktiv në përmirësimin e pozitës së tyre dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

¹⁰ e disponueshme në <http://www.ombudsman.rs/index.php/lang-sr/misljenja-preporuke-i-stavovi>

¹¹ Numri i rasteve të hetuara nga Mbrojtësi i qytetarëve, e të cilat kishin të bëjnë me dhunën në shkollë në periudhën 2008 – 2011, në mënyrë të qëndrueshme është sjellë rreth 8-10% të numrit të përgjithshëm të rasteve që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtës së fëmijës

Iniciativa është shndërruar në një thirrje publike, drejtuar të gjithë vajzave dhe djemve të moshës 13 deri 17 vjeç që banojnë në territorin e Republikës së Serbisë. Me dëshirë që të jetë i arritshëm për një numër sa më të madh të fëmijëve, thirrja publike është publikuar në gazetën e përditshme "Blic", është i dorëzuar në të gjitha administrata të shkollave për ta shpërndarë atë në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme dhe është i postuar në faqet e internetit të Mbrojtësit të qytetarëve: www.pravadeteta.rs i www.zastitnik.rs. Falë bashkëpunimit me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, thirrja publike është dërguar në të gjitha institucionet e mbrojtjes sociale për fëmijët, qendrës për kujdesin familjar dhe të gjitha qendrave për punë sociale, në mënyrë që edhe fëmijët të cilët janë në sistemin e sigurimeve sociale të kenë mundësinë e aplikimit. Në këtë mënyrë, kushtet për regjistrim, informata në lidhje me atë se kush mund të aplikojë dhe çfarë duhet të përmbajë aplikimi, të jenë publike dhe gjerësisht në dispozicion.

Grupi prej 30 fëmijëve që e përbëjnë panelin e këshilltarëve të rinj, është i formuar në nëntor të vitit 2010, duke tërhequr "nga një kapelë" edhe në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- përfaqësim të barabartë të djemve dhe vajzave;
- përfaqësim të barabartë të nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme
- përfaqësimi i barabartë i fëmijëve nga të gjitha rajonet / zonat e territorit të Republikës së Serbisë, duke u bazuar në të dhënat e Ministrisë së arsimit për numrin e fëmijëve në shkollat e të gjitha administratave të shkollës
- përfaqësimi i fëmijëve nga grupet e shoqërisë së ndjeshme në veçanti:
 1. të paktën një fëmijë përfaqësues i pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë;
 2. të paktën një fëmijë me nevoja të veçanta;
 3. të paktën tre fëmijë të cilët nuk jetojnë në familjet prindërore ose nuk kanë kujdes prindëror dhe janë në sistemin e mirëqenies sociale, sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe politikës sociale.

Të gjitha kriteret e mësipërme janë përmbushur plotësisht, kështu që Paneli i këshilltarëve të rinj e bën grupin homogjen të moshës së njëjtë, pavarësisht nga dallimet e tyre të ndërsjella.

Në mënyrë që të realizon qëllimet e panelit të këshilltarëve të rinj, Mbrojtësi i qytetarëve pas realizimit të trajnimit të anëtarëve të panelit dhe vlerësimit të aftësive të tyre për pjesëmarrje të pavarur në projektin kërkimor, ka përgatitur mjetet e nevojshme hulumtuese (pyetësor) dhe në periudhën e planifikuar kohore prej katër muajve, ka zhvilluar një studim me titull "zbatimi i rregulloreve për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla.

HULUMTIMI DHE RAPORTI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE DHE PANELIT TË KËSHILLËTARËVE TË RINJ

Raporti i Mbrojtësit të qytetarëve në mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna në shkolla, është i bazuar në:

- a) rezultatet e hulumtimit, të kryera në periudhën nga mars deri në qershor 2011, nga fëmijët - anëtarët e Panelit të këshilltarëve të rinj; dhe
- b) të dhënat të cilat Mbrojtësi i qytetarëve i ka siguruar duke vepruar sipas ankesave të qytetarëve dhe vetiniciativës, kur kishte dijeni për shkelje të mundshme të të drejtave të fëmijëve.

Në bazë të analizës së të dhënave të mbledhura dhe të dhënave në dispozicion, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar problemet primare, dhe më pas në rekomandimet i ka theksuar hapat e nevojshme praktike që organet relevante të shtetit dhe institucionet arsimore dhe të edukimit duhet ndërmarrë brenda kompetencave dhe përgjegjësisë të tyre me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes në institucionet e arsimit dhe edukimit.

HULUMTIMI I PANELIT TË KËSHILLËTARËVE TË RINJ

Hulumtimi është kryer me qëllim të mbledhjes së të dhënave për trajtimin e shkollave fillore dhe të mesme në Serbi në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, pas marrjes së protokollit të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në institucionet arsimore dhe Rregullores për protokollin e trajtimit në institucionet në përgjigje ndaj dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes dhe për të përcaktuar nëse shkollat kanë filluar zbatimin e rregullave dhe protokolleve dhe në çfarë mënyre.

Qëllimet dhe supozimet e hulumtimit

Qëllimet specifike të këtij hulumtimi ishin që:

- të mësojnë dhe të vlerësojnë qëndrimet e nxënësve në lidhje me përhapjen e dhunës në shkolla;
- të përcaktojnë nëse shkollat i kanë informuar nxënësit në lidhje me të drejtat e tyre dhe përgjegjësisë së shkollës në parandalimin dhe mbrojtjen e nxënësve nga dhuna;
- të marrin informacion mbi masat e marra në rastet e dhunës në shkolla, si dhe nëse shkollat kanë ndërmarrë masat e parandalimit, ndërhyrjes dhe mbështetjes sipas protokollit dhe Rregulloreve;
- të marrin informacion mbi përmbushjen e detyrimit të shkollave për të formuar Ekipin për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja dhe për këtë t'i njoftojnë nxënësit;
- t'i trajnojë, fuqizojë dhe mbështes fëmijët për të marrë pjesë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në shkolla;
- të hartojë dhe zbatojë një hulumtim pjesëmarrës të fëmijëve për dhunën në shkolla.

Në përcaktimin e objektivave dhe metodave të hulumtimit është nisur nga supozimet e mëposhtme:

- zbatimi i rregulloreve dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në institucionet e arsimit zhvillohet shumë ngadalshëm dhe në mënyrë jo adekuate;
- nuk është ushtruar kontrolli i organizuar dhe gjithëpërfshirës në zhvillimin e këtyre rregullave dhe standardeve në shkolla;
- mungesa e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në mes institucioneve arsimore dhe Ministrisë së arsimit dhe shkencës, gjegjësisht administratës së shkollës në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna;
- nuk ka të dhëna mbi formimin, aktivitetet dhe përvojës së Ekipit për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja;
- në shkollat nuk mbahen evidencat për rastet e dhunës në mënyrën e përcaktuar në Rregulloren dhe Protokollin e veçantë;
- nuk ka bashkëpunim i përshtatshëm dhe as aktivitetet e koordinuara midis institucioneve arsimore dhe organeve, institucioneve dhe organizatave tjera;
- masat e ndërmarra në shkollat nuk janë me karakter sistematik dhe nuk e karakterizohen me një qasje gjithëpërfshirëse;
- mungon përfshirja e fëmijëve në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes nga abuzimi dhe dhuna;
- mungon hulumtimi pjesëmarrës i fëmijëve dhe të rinjve, perceptimet dhe mendimet e tyre mbi dhunën dhe abuzimin në shkolla.

Qasja Metodologjike

Hulumtimi është kryer në dy faza:

I. Edukimi i anëtarë të Panelit të këshilltarëve të rinj të Mbrojtësit të qytetarëve në fushën e dhunës, keqtrajtimit dhe neglizhencës, dhe shfrytëzimi i fëmijëve dhe kontekstet në të cilat ato ndodhin, si edhe dokumenteve relevante ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, të ndërmarra me angazhimet e shtetit dhe mekanizmave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi. Gjatë trajnimit, këshilltarët e rinj të Mbrojtësit të qytetarëve kanë fituar njohuri të detajuara në lidhje me institucionin e Mbrojtësit të qytetarëve, rolin e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe detyrimet e përcaktuara të shkollës në mbrojtjen e nxënësve nga dhuna.

II. Mbledhja dhe analiza e të dhënave mbi dhunën në shkolla, të fituara nga anketimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, të kryera nga anëtarët e Panelit.

Në mbledhjen dhe analizën e të dhënave është përdorur një qasje sasiore. Në pyetësor është përdorur në teknikë anketuese anonime, e shkruar për mbledhjen e të dhënave, bazuar në vlerësimet e fëmijëve. Për qëllimet e anketimit është projektuar një pyetësor me 11 pyetje, të përshtatura për fëmijë,

prej të cilëve 7 pyetje ishin me zgjedhjet e përgjigjeve të ofruara, ndërsa 3 pyetje ishin me zgjedhje të hapur.


Mostra e hulumtimit

Analiza sasiore është kryer në total prej 1257 pyetësorëve.



Grafiku 1.

Anketimi është kryer në 72 shkolla, prej tyre 37 shkolla fillore dhe 35 shkolla të mesme (Figura 2).



Grafiku 2.

Në këtë mënyrë janë përfshirë 13 nga 15 administratave shkollore në territorin e Serbisë qendrore dhe KA të Vojvodinës: A. Sh. Beograd, A. Sh. Valjevo, A. Sh. Zaječar, A. Sh. Zrenjanin, A. Sh. Kragujevc, A. Sh. Kraljevo, A.Sh. Leskovc, A. Sh. Nish, A. Sh. Pozharevc, A. Sh. Sombor, A. Sh. Uzhice dhe A. Sh. Čačak.

Në hulumtim nuk janë mbuluar institucionet arsimore në dy administrata shkollore - Jagodina dhe Krushevc, si dhe administrata shkollore nga territori i Kosovës dhe Metohisë – Mitrovica e Kosovës dhe Ranilug¹².

REZULTATET E HULUMTIMIT

¹² Me administratat shkollore në territorin e Kosovës dhe Metohisë - A.Sh. e Mitrovicës së Kosovës dhe A.Sh. e Ranilugut - nuk kanë mundur të kontaktohen gjatë hulumtimit, dhe as gjatë thirrjes së hapur publike për të formuar Panele e këshilltarëve të rinj dhe materiale që kanë të bëjnë me aktivitetet e panelit, i cili është dërguar në administratat e shkollës


Rezultatet e hulumtimit janë prezantuar përmes variablave të hulumtimit dhe treguesve të tyre, me pyetje operationale të pyetësit:

1. Përhapja e dhunës në shkolla
 - a. dhuna midis nxënësve
 - b. dhuna e mësuesve ndaj nxënësve
2. Masat parandaluese të dhunës në shkollë dhe pjesëmarrja nxënësve në këto masa

Ekzistojnë dallimet e konsiderueshme edhe në numrin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të cilët nuk e kanë përjetuar dhunën në shkollat e tyre, kështu gjithsej 6% e fëmijëve të shkollave fillore dhe 23% të shkollave të mesme raportuan se nuk kishin përvojë me dhunë midis nxënësve.

Edhe pse për analizën statistikisht të rëndësishme cilësore të dhunës bashkëmoshatare, një numër jo i mjaftueshëm i nxënësve të shkollës fillore e ka theksuar, të dhënat e fituara konfirmojnë rezultatet e hulumtimeve të tjera që në shkollat fillore më shpesh ushtrohet dhuna ndaj fëmijëve më të rinj nga më të vjetrit.

- Fëmija, klasa V: "Nxënësit e klasës së tetë më shpesh ushtrojnë dhunë ndaj neve. Unë e kam një shok¹³ të cilin nxënësi i klasës së tetë e ka rrahur dhe i ka marrë atë çfarë ishte e tij".



Grafiku 4

DHUNA E MËSUESVE NDAJ NXËNËSVE


¹³ Shoku i gjeneratës

Kur është fjala për dhunën e mësuesit ndaj fëmijëve, të dhënat janë afërsisht të njëjtat me të dhënat nga hulumtimet¹⁴ e mëparshme, të cilat tregojnë se në shkollat e Serbisë në dekadën e fundit, sillet nga 20% deri në 30%¹⁵.

Në këtë hulumtim, 23% e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme kanë thënë se ishin dëshmitar të ndonjë forme të dhunës së mësuesve ndaj fëmijëve (figura 5).

Për dallim nga dhuna me bashkëmoshatarëve, dhuna e mësuesve ndaj nxënësve është më e shpeshtë në shkollat e mesme (figura 6), gjegjësisht mësuesit ka më shumë të ngjarë të përdorin ndonjë formë të dhunës ndaj fëmijëve më të vjetër, kështu që 26% e nxënësve të shkollave të mesme kanë pasur një përvojë të tillë, ndërsa 20% e fëmijëve e kanë hasur dhunën në shkollat fillore.


80% e nxënësve të shkollës fillore, dhe 74% e nxënësve të shkollës së mesme kanë deklaruar se nuk e dinë, ose nuk ka pasur abuzim të mësuesve ndaj nxënësve në shkolla.



Grafiku 5

¹⁴ Savović, B. (2001). Qëndrimet e nxënësve ndaj problemeve disiplinore në shkollat fillore dhe të mesme. Procedura e Institutit për hulumtimet pedagogjike, 33, 408-416

¹⁵ Popadiq, D. (2009). Dhuna në shkolla, Instituti i Psikologjisë, Beograd




Grafiku 6

2. Masat e parandalimit të dhunës në shkolla dhe pjesëmarrja e nxënësve në këto masa

Duke vlerësuar aktivitete të cilat deri tani, me qëllim të parandalimit të dhunës në shkolla, promovoi dhe ndërmoi Ministria e arsimit dhe shkencës, si dhe periudhën relativisht të shkurtër nga prurja e protokollit të Veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, abuzimit dhe neglizhencës në institucione arsimore – edukuese (të vitit 2007) dhe hyrja në fuqi e Rregullores për protokollin e sjelljes në institucione në përgjigje ndaj dhunës, abuzimit dhe neglizhencës (e vitit 2010), me këtë hulumtim janë përfshirë vetëm disa prej aktiviteteve preventive me anë të cilave shkollat janë zotuar me rregullore të përmendur.

Kemi hulumtuar që a janë nxënës të njoftuar që shkolla ka organizuar biseda, tribuna, debate ose ka siguruar materiale promovuese në temën e dhunës në shkolla; a ka siguruar trajnime për komunikim jo të dhunshëm, strategjitë e zgjidhjes së problemeve dhe aftësive e zgjidhjeve alternative të konflikteve; në cilën masë nxënësit kanë qenë të kyçur në këto aktivitete shkollore.


Janë fituar të dhënat se 60% e fëmijëve të anketuar besojnë se në shkollën e tyre nuk është ndërmarrë apo nuk e din nëse është ndërmarrë ndonjëra prej masave të cekura për zvogëlimin, shuarjen apo çrënjosjen e dhunës, për të cilat shkollat e kanë për detyrë sipas rregulloreve dhe protokollit të mësipërm



Grafiku 7


Në grafikun 8 është paraqitur rezultati i hulumtimit se shkollat e mesme kanë qenë më të angazhuara në shuarjen, zvogëlimin dhe zhdukjen e dhunës dhe për ate kanë informuar 44% të nxënësve të vetë.

Edhe pse fëmijët konsiderojnë se abuzimi është më e përhapur në shkolla fillore se të mesme, paradoksale është se shkollat fillore kanë ndërmarrë aktivitete preventive të parandalimit të dhunës më të pakta se shkolla të mesme (mungesa e këtyre masave edhe ka mundë të kontribuojë në zgjerimin më të madh të dhunës te filloristët). Mbi 60% të filloristëve nuk kanë qenë të informuar që shkolla ka ndërmarrë ndonjëherë prej aktiviteteve me qëllim të zvogëlimit dhe ishin më të angazhuar në parandalimin.




Grafiku 8

Sipas njohurive dhe vlerësimeve të nxënësve të anketuar, shkolla të mesme në masë më të madhe (53%) nga shkollat fillore (46%) janë të përkushtuar organizimit dhe përgatitjes së bisedave, tribunave, debateve dhe materialeve promovuese mbi temën e dhunës në shkolla (grafiku 9).




Grafiku 9

Për fat të keq, shkollat në masë të vogël të konsiderueshme ndërmerrnin masa më komplekse, por më efikase të parandalimit të dhunës dhe zhvillimit të tolerancës, si që janë të mësuarit e aftësive sociale dhe strategjive të zgjidhjes së problemeve, përvetësimi i aftësive për komunikim jo të dhunshëm dhe zgjidhjes alternative të konflikteve. Rezultatet e hulumtimit treguan se 65% të nxënësve të shkollave të mesme nuk kanë qenë të udhëzuar se shkollat e tyre kanë siguruar edukimet nga meditari dhe komunikimi jo i dhunshëm (grafiku 10). Mbi 70% të filloristëve nuk din ose konsideron që trajnime të këtilla nuk kishte në shkolla të tyre. Afro 30% të fëmijëve të intervistuar kishin njohuri që shkollat e tyre kanë siguruar trajnime të tilla, por prapë më shumë ishte te nxënësit e shkollave të mesme (35%) se sa te nxënësit e shkollave fillore (27%) (grafiku 11).



Grafiku 10




Grafiku 11

Edhe më të këqija janë të dhëna nga grafiku 12 mbi numrin e nxënësve në shkolla që kanë pas qasje në dokumente e hulumtuara të masave preventive, që tregojnë se më pak se 30% të fëmijëve kishin mundësi pjesëmarrje në këto hulumtime.



Grafiku 12

Edhe pse është e njohur që masat preventive tregojnë efikasitet më të lartë nëse ndërmerren te moshat më të reja, aktivitetet për parandalimin e dhunës në shkolla, sipas përvojës së fëmijëve, në masë të konsiderueshme ndërmerren në shkolla të mesme (32%) se sa në ato fillore (23%) (grafiku 13).




Grafiku 13

3. Ekipi për mbrojtje nga dhuna, abuzimit dhe mospërfilljes


Njohurit e nxënësve për formimin e Ekipit

Rezultatet e hulumtimit treguan se në masë më të vogël janë zbatuar rregulloret për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla në pjesën në të cilën ka të bëjë me obligimin e shkollave që të formojnë Ekipin për mbrojtje nga dhuna, abuzimit dhe mospërfilljes. Afro 70% të nxënësve nga shkollat fillore dhe të mesme në territorin e Serbisë qendrore dhe KA të Vojvodinës tregojnë se shkolla nuk ka ose nuk kanë njohuri që shkollat kanë Ekip për mbrojtje nga dhuna, abuzimit dhe mospërfilljes (grafiku 14).

Nxënësit e shkollës së mesme janë të informuar në numër më të madh (35%) në krahasim me nxënësit e shkollës fillore (29%), lidhur me formimin e Ekipit nga shkolla e tyre (Grafiku 15)



Grafiku 14




Grafiku 15

Informimi i nxënësve për atë se kush janë anëtarë të Ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja dhe si mund t'iu drejtohen.

Rezultatet e fituara në lidhje me se a dinë nxënësit se kush janë anëtar të Ekipit dhe si mund të i drejtohen në rast dhune, tregojnë se edhe ata nxënës që kanë njohuri për ekzistimin e Ekipit në shkollë, e të cilët janë afro 30%, nuk kanë marrë informata të plota dhe adekuate për Ekipin, të cilën shkollë ka qenë e obliguar të ofrojë, sepse gjysma nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në hulumtim nuk dinë kush janë anëtar të Ekipit, kurse gjithsej 2% të nxënësve dinë përgjigje në këtë pyetje (grafiku 16).

Pasojnë përgjigjet (afro 30%) në të cilat Ekipi paraqet kombinime të ndryshme jo të sakta ose jo të plota mbi të punësuarit; 7% përbëjnë përgjigjet që Ekipin e përbënë policia, gjegjësisht sigurimi i


shkollës (të pa varur ose me ndonjë person të punësuar në shkollë). 4% të nxënësve mendojnë se Ekipin e përbëjnë vetë nxënësit, qofshin ata nxënës të trajnuar (ndërmjetësues), anëtarë të ekipit të moshatarëve ose parlamenti i nxënësve; deri sa 3% të tyre mendojnë se Ekipin e përbënë shërbimi profesional, d.m.th. psikologu/ose pedagogu i shkollës.



Grafiku 16

Më shumë se gjysma e nxënësve të shkollave fillore (55%) në pyetje kush e përbënë Ekipin janë përgjigjur: askush; nuk di, nuk ekziston Ekipi, supozoj....., ndoshta...(grafiku 17).


Mirëpo, edhe shumica e përgjigjeve të tjera të fituara në shkollat fillore, të ndara në 7 grupe (grafiku 17), paraqesin kombinime jo adekuate. Përgjigje më të shpeshta janë (23%) që Ekipin e përbënë ndonjëri prej kombinimeve prej të punësuarve, që kanë qenë të njohura për veprime shumëvjeçare të shkollave në raste dhune para prurjes së Protokollit dhe Rregullores, si që janë: shërbimi profesional psikolog – pedagog me arsimtarin e lëndës; arsimtari i trajnuar (arsimtari i edukatës qytetare); shërbimi psiko – pedagogjik me arsimtarin kujdestar; psikolog/pedagog me drejtorin/zëvendësin. Pastaj vijnë përgjigjet që Ekipin e formojnë vetëm arsimtarët/arsimtari koordinator ose ndonjëri prej kombinimeve të arsimtarëve me nxënës të trajnuar (7%). Përafërsisht në numër të barabartë (2%) janë paraqitur përgjigje që Ekipin e përbënë vetëm psikologu, gjegjësisht pedagogu; vetëm drejtori/sekretari; drejtori/sekretari me këshillin e shkollës/parlamentin e nxënësve ose me këshillin e prindërve; vetëm nxënësit dhe atë nën ombrellën e parlamentit të nxënësve, ekipit të moshatarëve, gjegjësisht, nxënësit të trajnuar për meditim. 4% të filloristëve mendojnë se Ekipi për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja e përbënë polici shkollor, gjegjësisht sigurimi, të pavarur ose me ndonjërin të punësuar si që janë drejtori ose psikologu/pedagogu i shkollës.



Grafiku 17

Edhe në mes të nxënësve të shkollave të mesme numri më i madh i tyre (45%) të cilët në pyetje kush e përbënë Ekipin përgjigjen: askushi; nuk di, nuk ka Ekip, supozoj..., ndoshta..... (grafiku 18).

Përgjigje të tjera të nxënësve të shkollave të mesme tregojnë më pak shpërndarje (mundë të ndahen në 5 grupe përgjigjesh), por ngjashëm të rreshtuar. Përqindja më e madhe e përgjigjeve(29%) është se Ekipi përbëhet nga ndonjëri prej kombinimeve të njohura të të punësuarve që veprojnë në raste dhune, si që janë: shërbimi profesional psiko – pedagogjik me arsimtarin e lëndës; arsimtari i trajnuar (arsimtari i edukatës qytetare); shërbimi psiko – pedagogjik me arsimtarin kujdestar; psikolog, pedagog dhe drejtori/zëvendësi. Nxënës të shkollave të mesme në përqindje më të lartë se filloristët (11%) mendojnë se anëtar i më i rëndësishëm i Ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja është polici i shkollës ose sigurimi, i pavarur ose me ndonjë të punësuar si që janë drejtori ose psikolog/pedagog i shkollës. Pastaj vijojnë përgjigjet (6%) që Ekipin e përbëjnë vetëm nxënës (parlamenti i nxënësve, ekipi i moshatarëve, gjegjësisht, nxënës të trajnuar për meditim ose nga „shkolla pa dhunë“); vetëm psikolog, gjegjësisht pedagog (3%); e vetëm 1% të tyre përmend drejtorin/sekretarin, ose drejtorin/sekretarin me këshillin e shkollës/parlamenti i nxënësve ose me këshillin e prindërve.



Grafiku 18

Në bazë të shpërhapjes së madhe të përgjigjeve të nxënësve, e pasi që ka të bëjë me shkolla të rregullta me strukturë dhe organizim¹⁶ të njëjtë, padyshim mund të konkludohet që shkollat nuk i kanë informuar në mënyrë adekuate informata të plota për atë se kush e përbën Ekipin. Përveç kësaj, implementimi i këtij obligimi ishte shumë laramane dhe e pa barabartë, gjegjësisht, Ekipi në shkolla formohej në mënyrë të paorganizuar, d.m.th. nga rasti në rast dhe/ose çdoherë me anëtarë të tjerë. Në çdo rast, janë shumë faktor që kanë mundë të ndikojnë hutimit të nxënësve, prandaj ata për anëtar të Ekipit binin vendime ose spekulime në bazë të supozimeve të tyre, të dhënave jo të plota në dispozicion ose përvojave të më parme.

Gjithashtu, te nxënësit është i dukshëm konfuzioni në lidhje me formimin të disa organeve të reja të nxënësve, qëllimeve të tyre fushëveprimit të tyre dhe angazhimit: ekipi i moshatarëve, parlamenti i nxënësve, ndërmjetësues bashkë-moshatar, nxënës nga „shkolla pa dhunë“.

Vetëm 4% të fëmijëve nga shkollat e hulumtuara kanë ditë si të drejtohen anëtarëve të Ekipit (grafiku 19), që mundë të konsiderohet numri i papërfillshëm.


Posaçërisht shqetësuese është e dhëna e fituar në pyetje se si fëmijët, në raste dhune, mundë të drejtohen Ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimit dhe mospërfilljes. Afro gjysma e fëmijëve janë përgjigjur me: kurrqysh, askush nuk do të dëgjojë; nuk paraqesin; nuk di; ose shkolla nuk ka Ekip.

- „A mundem a ? Jo edhe në shkollën time“
- „Mund vetëm të heshtim dhe durojmë rëniet dhe dhunë në nivele psikike dhe fizike“
- „Askush nuk guxon dhe nuk do të i drejtohet pedagogut“

¹⁶ Me hulumtimin është përfshirë vetëm një shkollë speciale dhe numri i nxënësve të anketuar (më pak se 10) i papërfillshëm në krahasim me numrin e përgjithshëm të nxënësve të anketuar

Përveç që afro gjysma e nxënësve kanë shprehur mosbesim që do të i ofrohet ndihma dhe përkrahja, në disa prej përgjigjeve është vërejtur edhe mungesë shprese nga rrethi i dhunës:

- Fëmija, SHF: „...shpesh kotë, sepse arsimtarët kanë fyer nxënësit me fjalë.”



Grafiku 19

(prevod grafikona 19):

kako ucenici... - si mund t'i drejtohen nxënësit Ekipit për mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja

preko zaposlenih... - përmes të punësuarve në mënyra të zakonshme

pozovu nekog...-të thërrasin dikë nga Ekipi

ne zna/...-nuk di/kurrsesi/nuk ka Ekip/askush nuk do të dëgjojë/nuk paraqiten

bez odgovora – pa përgjigje

ostalo – të tjera


Edhe nxënësit që kanë zbatuar anketën raportojnë që në teren kanë hasur në komente të nxënësve që kanë shprehur mosbesimin e tyre dhe pritjet që asgjë nuk do të ndryshojë.

Anëtarët e Panelit kanë grumbulluar edhe të dhëna vijuese: afro 90% të shkollave nuk ka cekur në vende për informim dhe shpallje asnjë të dhënë në raport me Ekipin, kurse 30% të shkollave as nuk ka tabelë të shpalljeve dedikuar informimit të nxënësve.

Rezultatet e cekura të hulumtimit padyshim tregojnë që shkollat nuk kanë përmbushur obligimin e vetë që informata e ekzistencës së Ekipit për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja

dhe anëtarëve të tyre të u mundësohet të gjithë fëmijëve/nxënësve pa dallim dhe që emrat e anëtarëve të Ekipit të paraqiten në vend të dukshëm¹⁷.

Në pajtim me këtë duhet të shikohen edhe të dhëna që 40% të filloristëve dhe nxënësve të shkollave të mesme kanë njohuri që formimi i Ekipit është obligimi i të gjitha shkollave (grafiku 18 dhe 19), prandaj mundë të konkludohet, edhe pse ishin të obliguara, shkollat nuk kanë kontribuar si informimit të nxënësve për Ekipin, ashtu edhe të drejtave të fëmijëve dhe obligimin e shkollave për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.



Grafiku 20

Prevod grafikona 20:

Formiranje tima...-formimi i Ekipit për mbrojtjen nga dhuna është obligim i përcaktuar për të gjitha shkollat

Ne znam – nuk e di

Znam – e di

¹⁷ Protokoli i Veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja në ente arsimore – edukuese (2007)



Grafiku 21

prevod grafikona 21

to je propisana...-është obligim i përcaktuar për të gjitha shkollat

srednje skole – SHM


osnovne skole - SHF

4. Veprimi i shkollave në raste të dhunës

Nxënësit kanë marrë udhëzime që në pyetje të hapur si janë zgjidhur rastet e dhunës, të përgjigjen me përshkrim të shkurtër të masave dhe hapave të ndërmarra të veprimit të shkollës (grafiku 22). Kanë komunikuar se në 40% të rasteve të dhunës në shkollat e tyre është vepruar në mënyra të vjetëruara, të zakonshme dhe të njohura, që janë ndërmarrë edhe para se të miratohet Protokoll i Rregullores së cekur dhe atë si për nga e masave të ndërmarra, ashtu edhe në se kush i ka zbatuar.

Afro 35 % të përgjigjeve ka treguar për masa joadekuate dhe/ose mungesë të veprimit të shkollës në raste dhune. Gjithashtu 8% të nxënësve ka cekur se në rastet e dhunës kryesisht janë zbatuar sanksione (përgjigjet e filloristëve: vërejtje, dërgimi në kutin e klasës, zvogëlimi i notes së sjelljes, procesi disiplinor; përgjigjet e nxënësve të shkollave të mesme: vërejtje, zvogëlimi i notës së sjelljes, procesi disiplinor, masat edukativo – disiplinore, përjashtimi nga shkolla, pastruar shkollën të shtunave, etj.). 9% të nxënësve në përgjigjet e tyre kanë treguar se ka ardhur deri te eskalimi i dhunës , gjegjësisht, këto raste kanë përfunduar me rrahje, përleshje, etj. 7% e të anketuarve në pyetjen si zgjidhen rastet e dhunës në shkolla janë përgjigjur: kurrqysh; nuk zgjidhen; nuk ka Ekip; nxënësit nuk i drejtohen askujt ose ndërmjet veti i zgjedhin; nxënësit nuk flasin dhe durojnë; mbulohe...

Shqetësuese është se në këtë pyetje të hapur vetëm 5% të nxënësve komunikuan se nuk kishte raste dhune, që është numri më i vogël në krahasim me 15% të nxënësve të cilët në përgjigje të komunikuar kanë zgjidhur përgjigje se nuk kanë hasur në raste dhune në shkolla. Ky vlerësim për shtrirjen e dhunës në shkolla, statistikisht është më valide nga vlerësimi nga vlerësimi të cilën e kanë dhënë fëmijët në pyetje të parë (përmes përgjigjeve), për shkak të shumë faktorëve: fjala është për pyetjen e përsëritur(kontrolluese), e tipit të hapur, e fëmijët përmes tij kanë hyrë më në thellësi të analizave të dhunës në shkolla, duke u nisur nga përvoja personale dhe duke kujtuar për raste konkrete në të cilat kanë marrë pjesë gjegjësisht ju kanë nënshtruar dhunës.



Grafiku 22

Prevod grafikona 22:

Kako su se resavali...-si janë zgjidhur rastet e dhunës në shkolla

Razgovorom...- me bisedë (pajtimi): shërbimi i ndërmjetësimit nga bashkëmoshatarët, kujdestari/drejtori + prindi

Samo kazna – vetëm dënimi

Nasilje...- me dhunë (rrahja, përleshja, „dhuna sjell dhunë“)

Ne resavaju se...--nuk zgjidhen/vetë nxënësit, ndërmjet veti/nxënësit heshtin dhe durojnë/mbulohet

Samo p-p sluzba – vetëm shërbimi i ndërmjetësimit nga bashkëmoshatarët

Samo staresina – vetëm kujdestari

Policajci...-policët me apo pa të punësuar

Ne zna...-nuk di/pa përgjigje

Nije bilo...-nuk ka pasur/nuk ka dhunë

Mund të quhet si kuriozitet e dhëna se vetëm 1% të rasteve të fëmijët ka qenë i njohur fakti i ekzistimit të Ekipit për mbrojtje kundër dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes.

Në 40% të rasteve të dhunës në shkolla është zgjidhur në mënyra të njohura dhe të zakonshme – me biseda, i cili ka përfunduar me pajtim ose dënim. Biseda është zhvilluar në kombinime të ndryshme: shërbimi profesional psiko – pedagogjik me kujdestarin/drejtorin ose në ato ka marrë pjesë drejtori me kujdestarin e klasës (qoftë nëse në to merrnin pjesë prindër apo jo). Gjithsej 9% të përgjigjeve ishin se në ato merrnin pjesë: kryesisht psikolog-pedagog(5%) ose kujdestari i klasës (2%), gjegjësisht, që rolin kryesor e kishte polici i shkollës/sigurimi, i pavarur ose me dike të punësuar në shkollë (2%).

Fëmijët vërejtën që veprimet që ndërmarrin shkollat në raste dhune – të vjetruara, mirë të trasuar dhe të njohura, që shpesh masat janë joadekuate ose të drejtuara në minimizimin ose mbulimin e dhunës, e shumë shpesh ndodhë që shkolla nuk ndërmerr asnjë aktivitet, që ka për pasojë përsëritjen e dhunës deri te eskalimi i tij. Këto rezultate të hulumtimit, si dhe të dhëna që paraqitet numri i madh i pjesëmarrësve në zgjidhjen e problemit, dërgon në përfundim se shkollat intervenimet e tyre në raste dhune i ndërmarrin në mënyrë të paorganizuar, nga rasti në rast, dhe se nuk ka veprime të organizuara dhe planifikuara mirë, duke filluar nga vlerësimi i rrezikut deri te planifikimi dhe prurjes së vendimeve për masat e intervenimit dhe përkrahjes që do të ndërmerren, si dhe që plotësisht mungojnë tri nivele të intervenimit varësisht nga intensiteti, shpeshtisë dhe pasojave të dhunës, abuzimit dhe mospërfilljes, në mënyrë të paraparë me Protokollin dhe Rregulloren.

PROBLEMET PRIORITARE NË PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA, KEQTRAJTIMI DHE MOSPËRFILLJA NË SHKOLLA

Në bazë të rezultateve të hulumtimit të kryer lidhur me veprimet e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Serbisë përkitazi me parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe në bazë të të dhënave të cilat i ka siguruar Mbrojtësi i qytetarëve përmes procedurave të kontrollit të ligjshmërisë dhe të rregullsisë në punën e organeve, institucioneve dhe organizatave, janë vërejtur problemet dhe sfidat vijuese prioritare:

I

Shkalla e dhunës në shkolla mbetet i pandryshuar në raport me hulumtimet e mëhershme, edhe përkundër faktit se janë miratuar dokumentet strategjike me synim luftimin dhe parandalimin e dhunës mbi dhe ndërmjet fëmijëve dhe përkundër faktit që ligji aktual, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, përmbajnë rregulla të qarta dhe të obligueshme të cilat parashohin obligimet të cilat

institucionet e arsimit dhe edukimit si dhe organet shtetërore i kanë në dispozicion për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët dhe nxënësit nga dhuna në institucionet edukativo-arsimore

II

Shkollat nuk i njohin format jo fizike të dhunës apo, edhe nëse i vërejnë, nuk iu japin asnjë domethënie gjegjëse, gjë që ka për pasojë mungesën e veprimeve të duhura nga shkollat në këso raste. Dhuna verbale, madje edhe disa forma të dhunës fizike (shkatërrimi i pronës së fëmijëve, kokrrizat, shtyrja, goditja) cilësohen si “grindje”, “lojë fëmijësh”, “shaka” dhe prandaj as nuk ndërmerren kurrfarë masash të orientuara kah ndalimi i dhunës dhe ofrimi i mbrojtjes së viktimës. Në rastet kur dhuna verbale apo format tjera të dhunës jo fizike edhe identifikohen, masat të cilat ndërmerren kufizohen në bisedën me keqtrajtuesin dhe udhëzimin e viktimës që t’i “injorojë” sulmet, dhe që sulmuesit të mos i “kushtojë vëmendje”.

Shkollat janë më të gatshme të veprojnë në rastet e dhunës fizike të të rriturve, gjegjësisht të të punësuarve kundër fëmijëve, ndërsa në masë më të vogël kur fjala është për dhunën fizike ndërmjet bashkëmoshatarëve.

III

Shkollat më së shpeshti nuk kryejnë vlerësimin e nivelit të dhunës, ndërsa në rastet edhe kur bëhet vlerësimi, mungon planifikimi i masave dhe miratimi i Planit operativ të mbrojtjes, i cili është i obligueshëm tek dhuna e nivelit të dytë dhe të tretë.

IV

Shkollat mohojnë kompetencat dhe përgjegjësinë e vet për dhunën në të cilën marrin pjesë nxënësit e saj, nëse ato ndodhin jashtë hapësirave shkollore (madje edhe në afërsi të shkollës), pa marrë parasysh që rrënjët e bashkëveprimit të dhunshëm në raportet dhe rolet e nxënësve janë krijuar, gjegjësisht arritur në shkollë.

V

Masat e intervenimit të cilat shkollat i ndërmarrin në rastet e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve në numrin më të madh të rasteve janë të paorganizuara, të paplanifikuara dhe të paorganizuara, ndërmerren varësisht prej situatës, ndërsa efikasiteti i tyre nuk përcillet. Shkollat më së shpeshti injorojnë format fillestare të dhunës ndërsa reagojnë vetëm kur dhuna të jetë përshkallëzuar në ndonjë formë më serioze.

VI

Më së shpeshti, angazhimi i shkollës përfundon me zbatimin e masave eventuale represive kundër nxënësit i cili ka qenë i dhunshëm. Shkollat nuk ndërmarrin masa mbështetëse për nxënësin viktimë, dhe për këtë qëllim as nuk përpiqen të vendosin bashkëpunimin me prindërit, organin e kujdestarisë apo me entin shëndetësor.

VII

Në shumicën e rasteve shkollat nuk zbatojnë Protokollin Special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione edukativo-arsimore dhe Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucionet përgjegjëse për dhunë, keqtrajtim dhe mospërfillje apo e bëjnë këtë në mënyrë joadekuate dhe në masë jo të duhur. Ekipet për mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja nuk janë formuar apo përbërja e tyre nuk ishte e duhur, ndërsa veprimtaritë e Ekipit nuk janë në përputhje me Rregulloren dhe Protokollin. Është dukuri e shpeshtë që Ekipit të mos jetë fare i përfshirë në zgjidhjen e rasteve të dhunës.

VIII

Institucionet edukativo-arsimore dhe ekipet e tyre të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja nuk mbajnë evidencën e nevojshme lidhur me masat e ndërmarra parandaluese dhe intervenuese.

IX

Duke marrë parasysh vëllimin, intensitetin dhe format e dhunës të cilat janë të pranishme në shkolla, shkollat nuk ndërmarrin masa parandaluese në masë të duhur, para se gjithash, me qëllim që nxënësve, prindërve dhe të punësuarve t'iu dërgohet një porosi e qartë mbi "tolerancën zero" ndaj dhunës dhe që të informohen mbi aktivitetet të cilat i ndërmerr apo që do t'i ndërmerr shkolla në rastet e dhunës.

Numri i nxënësve të cilat kanë përfituar nga edukimi mbi ndërmjetësimin dhe komunikimin jo të dhunshëm është jashtëzakonisht i vogël, ku edhe ku numër është edhe më i vogël në grup moshë më të reja.

X

Posaçërisht vërehet një huti dhe paqartësi në veprimet e shkollave në rastet kur fëmijët njëkohësisht janë në rolin e keqtrajtuesit dhe viktimës. Në këto raste, dhuna ndaj një nxënësi të këtuillë më së shpeshti arsyetohet me dhunën e tij të mëhershme, ndërsa shkolla ngurron apo dështon që çdo bashkëveprimi të dhunshëm t'iu qaset në mënyrë sistematike, me çka nxitet paraqitja, zhvillimi dhe mirëmbajtja e "rrethit vicioz" të dhunës.

XI

Shkollat nuk janë në gjendje të kuptojnë që fëmijët me pengesa në zhvillim, posaçërisht me vështirësi në sjellje (si për shembull me sindromin ADHD), shpesh në rrezik më të madh që të bëhen viktimë të dhunës dhe keqtrajtues. Dhuna e cila ushtrohet ndaj tyre arsyetohet me atë që viktimë "provokon", ndërsa dhuna të cilën ushtrojnë këta fëmijë arsyetohet me vështirësinë e tyre në zhvillim. Në të dyja rastet, shkollat nuk ndërmarrin masat adekuate, deri sa të mos detyrohen t'i ndërmarrin nga ndonjë ngjarje alarmante.

XII

Madje edhe në rastet e formave të rënda të dhunës, shkollat në shumicën e rasteve, nuk iniciojnë bashkëpunimin me organet dhe institucionet tjera (qendra për punë sociale, policinë, institucionet shëndetësore). Këto organe kyçen vetëm kur i marrin informatat nga burimet e tjera, gjegjësisht, kur dhuna në shkolla të jetë zgjeruar përtej shkollës dhe të jetë përshkallëzuar në kryerjen e veprës e cila me ligj konsiderohet e dënueshme.

XIII

Shkollat nuk merren me pozitën e nxënësit i cili ishte i dhunshëm dhe as me shkaqet e sjelljes konkrete ndaj bashkëmoshatarëve. Incidenti kryesisht përfundon me shqiptimin e dënimit, përpjekjen e transferimit të fëmijës në shkollë tjetër apo përjashtimin e fëmijës nga shkolla e mesme, ndërsa mungon në tërësi mbështetja për nxënësit me prirje për dhunë. Shkollat nuk e kyçin organin e kujdestarisë, ndonjëherë as atëherë kur shkollat vërejnë që prapa dhunës së fëmijëve ekzistojnë rrethanat të cilat kërkojnë përfshirjen e sistemit familjar-juridik dhe mbrojtjes sociale.

XIV

Nuk ekziston një praktikë unike e organeve inspektuese gjatë mbikëqyrjes së rasteve të dhunës në shkolla: në raste të caktuara, kontrollohet zbatimi i Rregullores mbi protokollin e veprimit në institucione si përgjigje ndaj dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe Protokollit Special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo-arsimore, ndërsa në rastet tjera organet të cilët bëjnë mbikëqyrjen inspektuese madje edhe mohojnë kompetencat e veta në kontrollimin e zbatimit të Rregullores dhe Protokollit.

REKOMANDIMET

Duke u nisur nga të dhënat mbi praninë e gjerë të dhunës në shkolla dhe lëshimeve në zbatim të dispozitave dhe ndërmarrjes së masave preventive, luftimit dhe parandalimit të dhunës në shkolla, rekomandimet e Mbrojtësit të qytetarëve janë organizuar sipas temave kyçe dhe sipas bartësve të përgjegjësive për zgjidhjen e tyre.

I

Është e nevojshme që Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë të vendos në rend dite shqyrtimi e projekt Ligjit mbi të drejtat e fëmijëve, të cilin do ta parashtrojë Mbrojtësi i qytetarëve në përputhje me kompetencat e veta ligjore dhe i cili do të vë në zbatim standarde unike në lëmine e të drejtave të njeriut, përfshirë parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimit dhe mospërfillja, posaçërisht fëmijëve nga grupet e ndijshme.

II

Është e nevojshme që institucionet edukativo-arsimore, organet administrative kompetente për mbikëqyrjen e punës së këtyre institucioneve dhe Ministria e arsimit dhe shkencës, në punën e vet të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, të nisen nga:

. • fakti që dhuna në shkolla është çdo lloj i dhunës i ushtruar në hapësirën e cila i takon shkollës apo në kuadër të aktiviteteve shkollore, por edhe çdo dhunë shkaqet e së cilës gjenden në raportet dhe role e fëmijëve në ndërveprimin e dhunshëm, e që janë themeluar, gjegjësisht krijuar në ambientet shkollore;

. • përkufizimi i dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe formave të paraqitjes së tyre të paraparë me Protokollin e veprimit në institucione si përgjigje ndaj dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe me Protokollin special për mbrojtje të fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione edukativo-arsimore.

III

Është e nevojshme që institucionet edukativo arsimore zbatojnë në mënyrë të duhur dhe të plotë Ligjin mbi bazat e sistemit edukativo arsimor, Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe Protokollin special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione edukativo – arsimore, dhe në veçanti:

- T'i njoftojnë nxënësit mbi të drejtat e nxënësve dhe obligimeve të shkollës në mbrojtje nga dhuna;

- Të hartojnë programin vjetor të mbrojtjes, i cili do të përmbajë të gjitha elementet e parapara me Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes;
- Të formojnë ekipe për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja me përbërje e cila parashihet me Rregulloren për protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes.
- I cili i përgjigjet synimit dhe qëllimit për të cilin formohet ekipi; të kryejnë masa parandaluese, intervenuese dhe mbështetëse në mënyrë dhe me hapa të cilat janë paraparë me Rregulloren mbi protokollin e veprimeve në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe me Protokollin special për mbrojtje të fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo-arsimore;
- Që të mbajnë evidencë të rasteve, të përcjellin dhe të evidentojnë ndërmarrjen dhe efikasitetin e masave të tilla, të analizojnë gjendjen dhe të parashtrojnë raporte në përputhje me Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes.

IV

Është e domosdoshme që institucionet edukativo arsimore rregullisht ta vejnë në dispozicion Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe Protokollin special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo – arsimore për fëmijët, të punësuarit dhe prindërit/kujdestarët e nxënësve.

V

Është e nevojshme që institucionet arsimore të përgatisin informata të cilat synojnë nxënësit, të punësuarit dhe prindërit lidhur me ekzistimin e Ekipit për mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja, mbi përbërjen e tij, autorizimet dhe aktivitetet dhe mënyrën sesi dhuna mund të raportohet dhe si të kërkohet mbrojtja nga dhuna. Institucionet edukativo arsimore i vendosin këto informata në tabela të shpalljeve të cilave mund t'i qasen të gjithë, në panot, faqet e internetit dhe në mënyra të tjera me të cilin sigurohet që kjo informatë të jetë në dispozicion të gjithëve pa dallim.

VI

Është e domosdoshme që Ministria e arsimit dhe shkencës, në mënyrë të pavarur dhe përmes rrjetit të inspektorëve të arsimit, të kryejë kontrolle periodike nëse institucionet edukativo arsimore në punën e vet zbatojnë si duhet dhe në masë të plotë Rregulloren mbi protokollin e veprimit në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe Protokollin special për mbrojtje të fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione edukativo-arsimore, e posaçërisht:

- nëse Rregullorja mbi protokollin e veprimit në institucionet në përgjigje të dhunës keqtrajtimit dhe mospërfilljes dhe Protokollet speciale për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione edukativo-arsimore është në dispozicion për të gjithë;
- nëse institucioni iu ka vënë në dispozicion të gjithëve informatën mbi ekzistimin e Ekipit për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja, kush janë anëtarët e ekipit dhe në ç' mënyrë nxënësi mund të mbrohet nga dhuna;
- nëse institucioni ka miratuar Program për mbrojtje dhe nëse përmbajtja e tij është në përputhje me Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit, dhe mospërfilljes;
- nëse institucioni ka zbatuar aktivitete parandaluese në përputhje me Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes.

VII

Është e nevojshme që Ministria e arsimit dhe shkencës, në bashkëpunim me organe, organizatat, institucionet dhe subjektet tjera juridike, t'u ofrojë të gjithë nxënësve edukim të vazhdueshëm mbi zhvillimi e tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm, me format e përsëritura të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes si dhe mënyrave efikase të luftimit dhe parandalimit të dhunës dhe të hartojë dhe zbatojë në mënyrë periodike hulumtimet e fëmijëve mbi dhunën në shkolla.

VIII

Është e nevojshme që Ministria e arsimit dhe shkencës, në bashkëpunim me organet, organizatat, institucionet dhe subjektet tjera juridike, të organizojë edukim special periodik për arsimtarë dhe të punësuar të tjerë lidhur me zhvillimin e tolerancës, komunikimit jo të dhunshëm, keqtrajtimit dhe mospërfilljes, formave të përsëritura të tyre dhe mënyrave më efikase për parandalim dhe luftim të dhunës.

IX

Është e nevojshme që institucionet arsimore dhe edukative, gjatë ndërmarrjes së masave të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna, të realizojnë bashkëpunim të plotë me organet e kujdestarisë, policinë, institucionet shëndetësore dhe organet gjyqësore dhe organet, organizatat dhe institucionet tjera dhe që, krahas kësaj, të jenë iniciatorë të konferencës së rasteve.

X

Është e domosdoshme që institucionet arsimore dhe edukative, gjatë zbatimit të masave me qëllim të mbrojtjes nga dhuna, të ndërmarrin qoftë në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me organet tjera, të orientuara kah mbështetja dhe rehabilitimi i fëmijëve viktime dhe reintegrimin e tij/saj, si dhe rehabilitimin dhe reintegrimin e nxënësve në rolin e keqtrajtuesit.

XI

Masat e sanksionimit të fëmijës i cili ka shkaktuar dhunë, e posaçërisht masat e përjashtimit nga shkolla, të jetë masë e “zgjidhjes së fundit” dhe të zbatohet me një procedurë ligjore vetëm pasi të gjitha masat e parandalimit, rehabilitimit dhe masat e tjera të mbështetjes të cilat shkolla, qoftë vetvetiu apo në bashkëpunim me organet dhe institucionet tjera, të mos japin efekt. Masat ndëshkuese nuk mund të jenë alternativë e masave parandaluese dhe mbështetëse dhe vetë rehabilitimit, dhe as kompensim për lëshimin e institutit që këto masa t’i ndërmerr në kohë të duhur.

XII

Është e nevojshme që ministria e shkencës dhe arsimit të miratojë një akt nën-ligjor me të cilin rregullohen më për së afërmi kriteret për njohjen e formave të diskriminimit nga ana e të punësuarve, nxënësve apo palëve të treta në institucion, dhe një akt nën-ligjor me të cilin rregullohen më për së afërmi kushtet mbi mënyrën e njohjes së formave joverbale të keqtrajtimit të nxënësve nga ana e të punësuarit gjatë kujdesit, pushimit dhe rekreacionit dhe formave të tjera të punës edukativo-arsimore, në çka është i obliguar me Ligjin mbi sistemin edukativo arsimor.

ANEKS

KORNIZA LEGJISLATIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA, KEQTRAJTIMI DHE MOSPËRFILLJA NË SHKOLLA

Me pranimin dhe ratifikimin e dokumenteve të shumta ndërkombëtare, Republika e Serbisë është obliguar në krijimin e një kornize inkluzive kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi, mospërfillja dhe eksploatimi.

Nga dokumentet relevante ndërkombëtare dhe vendore do t'i veçojmë ato me të cilat sigurohet mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në lëmi të edukimit dhe arsimit, gjegjësisht në institucione edukativo-arsimore.

Renditja e instrumenteve juridike është dhënë në bazë të domethënies dhe aspekteve të përgjithshme të tyre. Pasi të jenë miratuar aktet e mangëta nënligjore, korniza ligjore për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja do të jetë rrumbullakosur.

KONVENTAT MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE¹⁸ ME PROTOKOLLET FAKULTATIVE¹⁹

Kur është fjala për të drejtat e fëmijëve, gjithsesi që instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar është Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, e cila obligon shtetet anëtare që çdo fëmije – duke marrë parasysh të drejtat dhe obligimet e prindërve²⁰ - t'i sigurojnë aso shkalle të mbrojtjes dhe kujdesit i cili është i domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe që, për këtë qëllim, të ndërmarrin të gjitha masat ligjvënëse dhe administrative. E bazuar në katër parime udhëheqëse – të drejtën në jetë, mbijetesë dhe zhvillim, jo diskriminim, pjesëmarrje dhe interesat më të mirë të fëmijëve – Konventa (ndër të tjera) obligon shtetet anëtare në ndërmarrje të masave për shkak të “mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mentale, lëndimeve dhe keqtrajtimeve, mospërfilljes apo sjelljes shpërfillëse, maltremit apo eksploatimit, përfshirë edhe abuzimin seksual”²¹.

Konventa obligon shtetet që çdo fëmije t'i sigurojë arsimim e cila është e orientuar kah “laramania e fëmijëve, talenteve, aftësive mentale dhe fizike deri tek aftësitë e tyre të skajshme; zhvillimi e respektit për të drejtat themelore, si dhe respekt për parimet e parapara me Konventën e Kombeve të Bashkuara... “ dhe „përgatitja e fëmijës për jetë të përgjegjshëm... në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë së poleve...“²². Duke interpretuar dispozitat e Konventës të cilat kanë të bëjnë me

¹⁸ Ligji mbi ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut („Gazeta Zyrtare e RSFJ-së – Marrëdhëniet ndërkombëtare“, nr. 15/90 dhe „Gazeta Zyrtare RSJ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare“, nr. 2/97)

¹⁹ Ligji mbi ratifikimin e Protokollit fakultativ mbi shitjen e fëmijëve, pornografisë së fëmijëve, krahas Konventës për të drejtat e fëmijës („Gazeta zyrtare e RSJ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 7/2002) dhe Ligji mbi ratifikimin e Protokollit fakultativ mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura krahas Konventës për të drejtat e fëmijës („Gazeta zyrtare e RSJ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare“, nr. 7/2002)

²⁰ Apo kujdestarit apo individëve të tjerë të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën

²¹ Neni 19 i Konventës për të drejtat e fëmijës

²² Neni 29 i Konventës për të drejtat e fëmijës

qëllimet edukative në kontekst të të drejtave të fëmijës në shkollim (neni 28 and 29 i Konventës), Komiteti për të drejtat e fëmijëve në Komentarin e përgjithshëm nr. 1 – Qëllimet edukative²³ cek se “arsimimi shtrihet përtej shkollimit formal dhe përfshin një spektër të gjerë të përvojave jetësore dhe proceseve të të mësuarit të cilët fëmijëve u mundëson, në mënyrë individuale apo kolektive, që ta zhvillojnë personalitetin, talentin dhe aftësinë e vet dhe të jetojnë një jetë të përmbushur dhe të kënaqshëm”. Komiteti në veçanti thekson se arsimimi cilësor është ai i cili nxit respektin për të drejtat e njeriut, dhe atë jo vetëm përmes përmbajtjes së planit mësimor por edhe përmes “procesit arsimor, metodave pedagogjike dhe rrethanave në të cilat zhvillohet arsimi”²⁴. Arsimimi duhet të ofrohet në një mënyrë e cila respekton dinjitetin e lindur të fëmijës, në përputhje me katër parimet udhëheqëse të Konventës e kjo, ndër të tjerash, nënkupton që “arsimimi duhet të ofrohet në një mënyrë e cila afirmon mënjanimin e dhunës në shkollë”²⁵. Qëllimi i arsimit është që çdo fëmijë të fitojë dhe të përvetësojë “shkathtësitë elementare jetësore dhe që asnjë fëmijë të mos largohet nga shkollat e të mos jetë i pajisur për t’u ballafaquar me sfidat të cilat pritet t’i has në jetë. Shkathtësitë elementare përfshijnë jo vetëm shkrim-leximin, por edhe shkathtësitë jetësore siç është aftësia... që të zgjidh konfliktet në mënyrë jo të dhunshme...”²⁶. Në Komentarin e përgjithshëm 13 – e drejta e fëmijëve që të mos i ekspozohet çfarëdo qoftë forme të dhunës²⁷, Komiteti ka dhënë interpretimin juridik për dispozitën 19 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, duke theksuar në veçanti që është obligimi i shtetit që të mbrojë fëmijën nga çdo formë e dhunës në të gjitha ambientet, përfshirë edhe shkollat. Komiteti posaçërisht ka vënë në pah faktin që dhuna ndaj fëmijës mund të paraqitet në forma më të ndryshme (jo vetëm në formë fizike), si dhe që dhuna, në kuptim të dispozitave të Konventës për të drejtat e fëmijës, konsiderohet edhe dhuna të cilën e ushtrojnë në shkollë fëmijët e tjerë dhe të rriturit.

Komiteti për të drejtat e njeriut, më 06.06.2008, në mbledhjen e 48-të të tij, ka miratuar Vrojtimet përmblyëse pas shqyrtimit të raportit të Republikës së Serbisë²⁸, ku ka shprehur shqetësimin e vet për shkak të “përhapjes së dhunës në shkolla, kryesisht në mesin e nxënësve”²⁹ dhe i ka rekomanduar Republikës së Serbisë që “të krijojë programe adekuate dhe aktivitete me synim...parandalimin e jotolerancës, dhunës në mes të bashkëmoshatarëve dhe diskriminimit në shkolla dhe në shoqëri në përgjithësi”³⁰.

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR FËMIJË

Duke pranuar se pozita e fëmijëve dhe e të rinjve në Republikën e Serbisë është e ngarkuar nga një varg problemesh, dhe duke pranuar nevojën që këtyre problemeve t’iu qaset në mënyrë sistematike dhe të organizuar, Qeveria e Republikës së Serbisë në vitin 2004 ka miratuar Planin kombëtar të veprimit për

²³ *Komentar i përgjithshëm nr. 1 Komiteti për të drejtat e fëmijës ka miratuar dhe publikuar më 17. 04. 2001. Në dispozicion në internet faqen <http://tb.ohchr.org/default.aspx?Symbol=CRC/GC/2001/1>*

²⁴ *Pika 2 e Komentarit të përgjithshëm nr. 1*

²⁵ *Pika 8 e Komentarit të përgjithshëm nr. 1*

²⁶ *Pika 9 e Komentarit të përgjithshëm nr. 1*

²⁷ *Komentari i përgjithshëm nr. 13. Komiteti për të drejtat e fëmijës ka miratuar dhe publikuar më 17. 04. 2001. Në dispozicion në internet faqen <http://tb.ohchr.org/default.aspx?Symbol=CRC/GC/2001/1>*

²⁸ *Gjendet në <http://ëëë2.ohchr.org/english/bodies/crc/crcs48.htm> Vrojtimet përmblyëse*

²⁹ *Pika 60 e Vrojtimit përmblyësor*

³⁰ *Pika 61.*

fëmijët³¹. Plani ka theksuar dhunën ndaj fëmijëve si një prej “problemeve prioritare strategjike kombëtare” dhe ka konstatuar se në Serbi mungon vetëdija mbi domethënien e problemit me të cilin ballafaqohen fëmijët, ballafaqim sistemor me problemet dhe zgjidhja e tyre, baza kombëtare e të dhënave për fëmijët e posaçërisht politika e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse në raport me fëmijët. Miratimi i Planit kombëtar të veprimit për fëmijët nuk paraqet vetëm përmbushjen e obligimeve të Republikës së Serbisë të cilat i ka marrë përsipër me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare – para se gjithash Konventën mbi të drejtat e fëmijëve – por edhe një kthesë të politikës shtetërore ndaj gjeneratës më të re dhe përfshirjen e politikës shtetërore për fëmijët në politikën e përgjithshme zhvillimore të vendit.

Plani kombëtar i veprimit për fëmijë është dokument strategjik i Republikës së Serbisë, i miratuar për periudhën 2004 deri 2015 dhe paraqet “planin e masave, aktiviteteve dhe programeve prioritare të cilat duhet të ndërmerren në vitet e ardhshme me synim krijimin e kushteve sa më të favorshme për jetën e fëmijëve, rritjen e tyre dhe përfshirjen në shoqëri”.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PARANDILIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA

Duke e përcaktuar parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna si një nga qëllimet prioritare të politikës së Republikës së Serbisë ndaj fëmijëve, duke pasur parasysh të dhënat mbi dhunën ndaj fëmijëve të cilat janë paraqitur në Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe duke u nisur nga parimet e parashtruara me këtë Studim që asnjë dhunë ndaj fëmijëve nuk është e arsyetuar dhe se dhuna ndaj fëmijëve mund të parandalohet, Qeveria në vitin 2008 ka miratuar Strategjinë kombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna³².

Strategjia konstaton se është e pamundur që të jepen të dhëna të sakta mbi dhunën të cilës i nënshtrohen fëmijët në Republikën e Serbisë, pasi që nuk ekziston sistemi i unifikuar i evidentimit dhe monitorimit të dhunës ndaj fëmijëve. Sistemit e ndryshme regjistrojnë në mënyra të ndryshme dukurinë e dhunës, ndërsa të dhënat e tyre – për shkak të parametrave të ndryshme të cilat i përdorin – krahasohen shumë vështirë. Strategjia ka konstatuar edhe problemet vijuese në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna:

- niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve mbi praninë e dhunës;
- toleranca për format e ndryshme të dhunës;
- edukimi i pamjaftueshëm, gjegjësisht mos ekzistues i opinionit publik se si të ballafaqohet me dhunë ndaj fëmijës;
- mungesë e strategjive gjithëpërfshirëse dhe mekanizmave sistemor për parandalim dhe reagim ndaj problemet e dhunës ndaj fëmijëve;
- legjisllacioni jo i zhvilluar sa duhet në këtë lëmi, si dhe mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e tyre;
- nevoja për ratifikimin e instrumenteve relevante për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- nevoja për zhvillimin e rrjetit shumë-sektorial për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;

³¹ ³² <http://www.savetzapravadeteta.gov.rs/sr/documents>

³² ³³ „Kumtari zyrtar i RS-së“, nr. 122/2008

- udhërrëfyes jo të zhvilluar sa duhet përkitazi me të drejtat e fëmijëve në lëmitë e ndryshme;
- sistemi i pazhvilluar informativ për grumbullimin e të dhënave mbi dhunën në familje;
- mungesa e protokollit për dokumentimin e dhunës;
- procedura e pazhvilluar e raportimit;
- hulumtimet e pamjaftueshme mbi shpeshtësinë e dhunës ndaj fëmijëve dhe vlerësimi i cenueshmërisë së fëmijëve ndaj dhunës dhe keqtrajtimit.

Strategjia ka të bëjë me të gjitha fëmijët në të gjitha ambientet dhe vë fëmijët para dy qëllimeve strategjike:

- zhvillimi i ambientit në të cilin do të realizohet e drejta e çdo fëmije që të jetë i mbrojtur prej të gjitha formave të dhunës, dhe
- themelimi i sistemit kombëtar të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e keqtrajtimit, mospërfilljes dhe shfrytëzimit.

Edhe sistemi arsimor e ka rolin e vet në realizimin e numrit të madh të qëllimeve specifike të cilat i ka përcaktuar Strategjia. Strategjia e parashih sistemin si faktor të rëndësishëm në:

- zhvillimin e tolerancës dhe kultivimin e formave jo të dhunshme të komunikimit;
- përfshirjen e tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm në programet edukativo-arsimore;
- përfshirjen e përmbytjes mbi parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve në planet dhe programet mësimore të shkollave fillore dhe të mesme;
- ofrimin e mbështetjes për programet të cilat krijojnë sisteme parandalimi, intervenimi dhe të mbështetjes në rastet e dhunës në ambientin shkollor;
- hartimi dhe zbatimi i programit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna e fëmijëve në konvikte dhe internate;
- organizimi i trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve, për fëmijët dhe me fëmijët, si dhe trajnim për fuqizim të fëmijëve për të njohur dhe paraqitur dhunën ndaj vetës dhe bashkëmoshatarëve të tyre;
- ofrimi i mbështetjes dhe nxitjes së iniciativës dhe veprimtarisë së fëmijëve në organizimin e aktiviteteve dhe manifestimeve me të cilat promovohet toleranca, respekti i ndërsjellë, bashkëpunimi, përgjegjësia dhe shkathtësitë e komunikimit;
- përfshirja e fëmijëve në organizimin e kampeve, tribunave, tryezave të rrumbullakëta, ekspozitave dhe evenimenteve të tjera edukative në temën e luftës kundër dhunës, promovimit të tolerancës, sjelljes konstruktive të konflikteve dhe të ngjashme;
- trajnimi dhe përfshirja e fëmijëve në hartimin dhe zbatimin e programeve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në institucione edukative dhe bashkësi lokale, me theks të veçantë në dhunë ndërmjet bashkëmoshatarëve;
- forcimin e rolit të parlamentit të nxënësve në parandalim dhe mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna;

- ofrimin e mbështetjes për zhvillimin dhe funksionimin e ekipeve të bashkëmoshatarëve për parandalim dhe mbrojtje të fëmijëve në institucionet edukativo-arsimore;
- ofrimi i mbështetjeve për programe të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në institucionet edukativo-arsimore;

Qëllimet specifike posaçërisht të rëndësishme, për realizimin e të cilëve janë të pashmangshme institucionet edukativo-arsimore janë:

- vendosja e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve relevantë;
- forcimi i aftësisë së të gjithë sektorëve për të njohur dhunën dhe situatat e dhunshme;
- zhvillimi i dijes dhe shkathtësive të ekspertëve për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në të gjithë sektorët;
- realizimi i programit të trajnimit për zbatimin e Protokollit të përgjithshëm dhe special për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- organizimi i trajnimit për komunikimit jo të dhunshëm dhe zgjidhjen kreative të konflikteve për të punësuarit në të gjithë sektorët;
- avancimi i aftësive të ekspertëve dhe zhvillimi i programeve për punë me kryesit e dhunës;

Futja e modulit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në programet e fakultetit në të cilat shkollohen ekspertët të cilët punojnë me fëmijë dhe familje është qëllimi specifik i Strategjisë, realizimi i të cilëve në mënyrë më efikase, do të sillte deri te rritja domethënëse e numrit të ekspertëve të cilët punojnë me fëmijë, posaçërisht në lëmine e arsimimit.

Roli i sistemit të arsimimit është shumë domethënës në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të evidentimit dhe përcjelljes së rasteve të dhunës, përmirësimit të cilësisë së të dhënave mbi llojet dhe rezultatet e dhunës ndaj fëmijëve dhe shkaqeve e pasojave të tyre, parandalimit të dhunës dhe mbrojtjes së fëmijëve, të cilët gjithashtu janë qëllime specifike të Strategjisë.

Strategjia në veçanti thekson se “parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna mund të zbatohet me sukses vetëm në partneritet me të gjithë sektorët e shoqërisë – institucionet shtetërore, shoqatat ndërkombëtare dhe vendore joqeveritare, organet lokale të vetëqeverisjes, institucionet shkencore dhe mjeteve të informimit publik”, ndërsa funksionin koordinuese në këtë proces duhet ta ketë Këshilli i qeverisë për të drejtat e njeriut.

LIGJI MBI BAZAT E SISTEMIT EDUKATIVO ARSIMOR

Më 11 shtator 2009, ka hyrë në fuqi Ligji mbi bazat e sistemit arsimor dhe edukativ³³, i cili për herë të parë rregullon në mënyrë më të detajshme dhe më të plotë pyetjen e mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja. Ky ligj është vazhdimësi e aktivitetit të cilin Republika

³³ „Kumtari zyrtar i RS-së“ nr. 72/09, 52/11

e Serbisë me miratimin e Planit kombëtar të veprimit për fëmijë, Protokollit të përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja dhe Protokollit special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo-arsimore. Me dispozitat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen nga dhuna në institucionet edukativo-arsimore, Ligji i ka ngritur rregullat dhe parimet e përgjithshme të përcaktuara me dokumentet strategjike në nivel të parimeve ligjore dhe rregullave të karakterit detyrues. Njëkohësisht, me miratimin e këtij ligji, Republika e Serbisë ka filluar me aktivitete konkrete për përmbushjen e obligimeve të marrë përsipër me ratifikimin e Konventës për të drejtat e njeriut dhe obligimet e veprimit sipas rekomandimeve të Komitetit për të drejtat e njeriut në vitin 2008.

Një prej qëllimeve të përgjithshme të arsimit dhe edukimit të cilat definojnë me këtë ligj është “arsimimi dhe edukimi në një institucion të rregulluar në mënyrë demokratike dhe përgjegjëse ku kultivohet...bashkëpunimi, toleranca... dhe ku është siguruar respektimi i plotë i të drejtave të fëmijëve, të nxënësve dhe të të rriturve”.³⁴ „Zhvillimi i aftësisë komunikuese, dialogut, ndjenjës së solidaritetit, bashkëpunimit cilësor dhe efikase me të tjerët dhe aftësia për punë ekipore dhe kultivimit të miqësisë” si dhe “zhvillimi dhe respektimi i barazisë racore, nacionale, kulturore, gjuhësore, fetare, gjinore, dhe moshore, tolerancës dhe respektimit të diversitetit”³⁵ me ligj definojnë si qëllime të arsimit. Qëllimi i procesit arsimor, ndër të tjera, është që pjesëmarrësit të jenë të aftë që në mënyrë të përgjegjshme dhe efikase të udhëheqin veten dhe aktivitetet e tyre dhe të komunikojnë në mënyrë efikase³⁶. Me këto dispozita, Ligji është harmonizuar me dispozitat e Konventës për të drejtat e njeriut të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e fëmijëve në arsim dhe qëllimet arsimore në përputhje me interpretimet të cilat i ka dhënë Komiteti për të drejtat e fëmijëve në Komentet e përgjithshme nr. 1 – Qëllimet arsimore.

Institucionet edukativo arsimore miratojnë rregullat e sjelljes me qëllim që në institucionet të sigurohet një respekt dhe mirëkuptim i ndërsjellë i fëmijëve, nxënësve, të të punësuarve dhe prindërve³⁷. Dy ndalesa të cilat i ka përcaktuar ky ligj janë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve: ndalesa e diskriminimit dhe ndalesa e dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes³⁸. Në institucione janë të ndaluara aktivitete me të cilat “rrezikohen, nënçmohen, diskriminohen dhe veçohen persona, gjegjësisht grup të personave, në bazë të përkatësisë: racore, etnike, gjuhësore, fetare apo gjinore, karakteristikave fizike apo psikike, pengesave në zhvillim dhe invaliditet, gjendjes shëndetësore, rritjes, origjinës shoqërore dhe kulturore, gjendjes pasurore, gjegjësisht orientimit politik “; ndalohet edhe nxitja apo mos parandalimi i aktiviteteve të tilla. Duke definuar nocionin e diskriminimit, ligji parasheh edhe obligimin e ministrit të arsimit dhe shkencës që, bashkërisht me ministrin për të drejtat e njeriut, të sjellin akte nënligjore me të cilat do të rregullohen kriteret për njohjen e formave të diskriminimit nga ana e të punësuarve, nxënësve dhe personave të tretë në institucion.

Ligji rregullon në detaje nocionin e dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes duke ndaluar dhunën fizike, psikike dhe sociale, keqtrajtimin dhe mospërfilljen e fëmijëve dhe nxënësve, dënimin fizik dhe fyerjen e

³⁴ neni 2 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

³⁵ neni 4 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

³⁶ neni 5 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

³⁷ neni 43 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

³⁸ neni 44 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

personalitetit, si dhe abuzimin seksual të fëmijëve dhe nxënësve dhe të të punësuarve“. Duke zbatuar në tekstin e dhunës të paraparë me Protokollin e përgjithshëm dhe Special për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja, Ligji definon që “me dhunë dhe keqtrajtim nënkuptohet çdo formë e sjelljes verbale dhe joverbale të kryer njëherë apo të përsëritur e cila ka për pasojë cenimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, zhvillimit dhe dinjitetit të fëmijëve, nxënësve apo të të punësuarve”. Format e dhunës për herë të parë kanë marrë përkufizimin ligjor:

- „mospërfillja apo sjellja e shkujdesur paraqet dështimin e institucionit apo të të punësuarit që të sigurojë kushte për zhvillimin e rregullt të fëmijës dhe nxënësit“;
- Me dhunë fizike konsiderohet “dënimi fizik i fëmijës dhe nxënësve nga ana e të punësuarve dhe personave të tjerë të rritur; çdo sjelljes e cila mund të sjellë deri te lëndimi i vërtetë apo i mundshëm trupor i fëmijës, nxënësit apo të punësuarit; sjellja e dhunshme e të punësuarit ndaj fëmijës, nxënësve apo të punësuarve të tjerë, si dhe nxënësve ndaj nxënësve apo të punësuarve të tjerë.“;
- Dhuna psikike është „sjellja e cila shpie deri te rrezikimi momental apo i përhershëm i shëndetit psikik dhe emocional dhe i dinjitetit të nxënësit apo të punësuarit “;
- Dhuna sociale është “përjashtimi i fëmijës dhe i nxënësit nga grupi i bashkëmoshatarëve nga format e ndryshme të aktiviteteve sociale të institucionit“;

Çdo formë e dhunës është e ndaluar, pa marrë parasysh nëse ushtrohet nga të punësuarit në institucion, nxënësit, prindërit, kujdestari apo ndonjë person tjetër.

Ministri i arsimit dhe shkencës përcakton me akte nën-ligjore protokollin e veprimit të institucionit në përgjigje të dhunës, si dhe kushtet më të hollësishme mbi mënyrat e identifikimit të formave të keqtrajtimit të nxënësve nga ana e të punësuarve gjatë kohës së kujdesit, pushimit dhe rekreacionit dhe formave të tjera të punës edukativo-arsimore.

Ndalesa e diskriminimit dhe ndalesa e dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes paraqesin një bazë ligjore për ndërmarrjen e masave nga ana e organeve të shkollës, dhe atë në masën e cila është paraparë për format më të rënda të shkeljes së detyrave të punës, gjegjësisht shkeljeve më të rënda të obligimeve të nxënësve. Personi i cili ka obligim që të ndërmer masa në raste të veprimeve kundër ndalesave të diskriminimit, keqtrajtimit dhe mospërfilljes është drejtori i institucionit³⁹.

Mbrojtja nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi forcohet edhe më tej me dispozitën ligjore e cila respektimin e këtyre ndalesave e definon edhe si të drejtë specifike të fëmijëve – të drejtën në mbrojtje nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja⁴⁰; përveç kësaj të drejte, ligji parasheh si të drejtë speciale të nxënësit dhe fëmijës edhe “punë cilësore edukativo-arsimore i cili siguron realizimin e parimeve dhe qëllimeve të arsimit“; „informatë të plotë dhe me kohë lidhur me pyetjet të cilat janë

³⁹ neni 62 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁰ neni 103 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

me rëndësi për shkollimin e tij/saj“, informimin e fëmijës dhe nxënësit mbi të drejtat dhe obligimet e tij/saj, dhe “realizimin e të drejtave të fëmijës dhe nxënësit, të drejtës në mbrojtje dhe trajtim të duhur në shkollë ndaj nxënësve edhe kur shkel obligimin e paraparë me këtë ligj“⁴¹. Në rast të shkeljes së këtyre të drejtave apo sjelljes jo të mirë të mësuesve apo të punësuarve, fëmija gjegjësisht nxënësi dhe(edhe) prindi/kujdestari i tij mund të parashtrojnë fletëparaqitje tek drejtori i institucionit, në afat prej 15 ditëve nga dita kur ka ndodhur rasti. Drejtori është i obliguar që këtë fletëparaqitje ga shqyrtojë dhe të vendos për atë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, në konsultim me fëmijën dhe prindërit e tij/saj dhe me të punësuarin⁴².

Mbrojtja nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja garantohet jo vetëm në nivel të institucionit arsimor, por edhe në nivel të organeve të administratës të cilët janë kompetent për mbikëqyrje të Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo-arsimor. Nxënësi, gjegjësisht prindi/kujdestari mund t’i parashtrojnë Ministrisë së arsimit dhe shkencës kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të nxënësit, për të cilin Ministria është e obliguar të vendos, nëse institucioni arsimor nuk mënjanon shkeljen të cilën Ministria e vë në pah⁴³.

Shkelja e ndalimit të diskriminimit dhe dhunës, abuzimit dhe neglizhimit është veprim gjegjësisht mosveprim të paligjshëm dhe të dënueshëm. Nëse një nxënës vepron në kundërshtim me ndalimin e diskriminimit dhe dhunës, abuzimit dhe neglizhimit, ai do t’i nënshtrohet përgjegjësisë arsimore - disiplinore ose kundër tij do të zhvillohet procedura arsimore – disiplinore⁴⁴ ku mund të shqiptohen masat arsimore - disiplinore të qortimit të drejtorit ose qortimit të këshillit të arsimtarëve, transferin e nxënësve prej klasës së pestë deri të tetë në një shkollë tjetër fillore me vendimin e Këshillit të arsimtarëve, me pëlqimin e prindërve, gjegjësisht kujdestarit dhe shkollës në të cilën kalon ndërsa për nxënësit e shkollave të mesme - përjashtimi i nxënësit nga shkolla gjegjësisht nga shkolla dhe konvikti.⁴⁵ Këto masa megjithatë nuk mund të shqiptohen nëse me nxënësin paraprakisht nuk është kryer punë edukative, e cila ka për qëllim ndryshimin e sjelljes së nxënësit (përjashtimisht, puna edukative nuk është një kërkesë për vendosjen e masave arsimore - disiplinore nëse me shkeljen e ndalimit të diskriminimit dhe dhunës, abuzimit dhe neglizhencës është bërë një kërcënim serioz i integritetit të viktimës)⁴⁶. 7 Nëse shkelja e ndalimit të diskriminimit dhe dhunës, abuzimit dhe neglizhencës është bërë nga punonjësi i institucionet arsimor, ai përkohësisht pezullohet nga puna⁴⁷ deri te përfundimi i procedurës disiplinore; në qoftë se, në këtë rast konstatohet përgjegjësia e të punësuarit, atij mund t’i shqiptohet masa disiplinore e përfundimit të punësimit dhe revokimit të licencës.

Ndalimi i diskriminimit dhe ndalimi i dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes paraqesin kategorinë specifike juridike në Ligjin mbi bazat e sistemit edukativo-arsimor. Shkeljet e këtyre ndalesave Ligji i ka barazuar me format më të rënda të obligimeve të punës, gjegjësisht të nxënësve, dhe parasheh edhe

⁴¹ neni 103 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴² neni 103 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴³ neni 111 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁴ neni 114 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁵ neni 115 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁶ neni 103 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁷ neni 149 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

dënime më të rënda ndaj personit i cili vepron në kundërshtim me ndalesat. Për dallim nga shkeljet më të rënda të obligimeve të punës, për të cilat me procedurë disiplinore të punësuarit mund t'i shqiptohen edhe masat e ndryshme disiplinore, kur është fjala tek shkelja e ndalesës së diskriminimit, dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes, të punësuarit (nëse konstatohet përgjegjësia e tij) mund t'i shqiptohet vetëm dënimi më i rëndë disiplinor – pushimi i marrëdhënies së punës.

Ligji jep bazë ligjore për formimin e organit profesional (ekipit) i cili merret me mbrojtjen fëmijëve nga dhuna: ekipi është organi profesional i institucionit⁴⁸, të cilin e formon drejtori dhe punën e të cilit e udhëheq.⁴⁹

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, përfshirë edhe kontrollin e “veprimeve të institucionit lidhur me zbatimin e ligjit, dispozitave të tjera në lëmine e edukimit dhe arsimit si dhe akteve të përgjithshme; realizimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe nxënësve, prindërve të tyre, gjegjësisht kujdestarëve dhe të punësuarve; realizimin e të drejtave dhe obligimeve të të punësuarve, nxënësve dhe prindërve të tyre, gjegjësisht të kujdestarëve dhe ofrimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve dhe të punësuarve nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi, mospërfillja dhe organizimeve dhe veprimtarive partiake në institucione “ e bën Ministria e arsimit dhe shkencës; këto punë si të besuara i kryejnë organet inspektuese të Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe të njësisë së vetëqeverisjes lokale (komunave, qyteteve)⁵⁰.

Inspekcioni arsimor është i autorizuar që pas mbikëqyrjes inspektuese (të rregullt, gjegjësisht të jashtëzakonshëm) me procesverbal të urdhëroj mënjanimin e mangësive të konstatuara. Inspektori i arsimit mund të sjellë vendim me të cilat institucionit i urdhëron masa (nëse institucioni nuk mënjanon lëshimin në përputhje me urdhërat nga procesverbali i inspekcionit arsimor), ndërsa në rast të shkeljes së ndalesës së diskriminimit, dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes, inspektori i arsimit është i autorizuar të parashtojë fletëparaqitjen organit kompetent, njësoj si me dyshimin për kryerje të veprës penale, kundërvajtjes, gjegjësisht shkeljes ekonomike⁵¹.

Rol specifik në realizimin e të drejtës së fëmijëve në mbrojtje nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillje ka Ministria për arsim dhe shkencë, përmes institucionit të mbikëqyrjes profesionalo-pedagogjike, të cilin e ushtrojnë këshilltarët arsimor në drejtoritë shkollore. Ata, ndër të tjera, “përcjellin respektimin e parimeve të përgjithshme dhe realizimin e qëllimeve edukativo-arsimore “ „këshillojnë dhe ofrojnë ndihmë profesionale institucionit në sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve, nxënësve dhe të punësuarve nga diskriminimi, dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucione” dhe “i propozon institucionit, ministrit dhe dhe organeve kompetente ndërmarrjen e masave të domosdoshme për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive në zbatimin e procesit edukativo-arsimor, punës profesionale gjegjësisht edukative dhe për avancim të tyre”⁵². Propozimet dhe rekomandimet e këshilltarëve arsimor nuk kanë karakter obligues juridik, dhe as natyrë represive; mirëpo, rekomandimet e këshilltarëve të

⁴⁸ neni 66 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁴⁹ neni 62 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁵⁰ neni 147 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁵¹ neni 148 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

⁵² neni 151 i Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor

arsimit të lëshuar pas mbikëqyrjes profesionale – pedagogjike janë bazë për veprim të organeve të tjera (Ministria e arsimit dhe shkencës dhe inspektionit arsimor), si dhe organeve në kompetencë të të cilëve është mënjanimi i lëshimeve të konstatuara në punën e institucionit.

RREGULLORJA MBI PROTOKOLLIN E VEPRIMIT NË INSTITUCIONE NË PËRGJIGJE TË DHUNËS, KEQTRAJTIMIT DHE MOSPËRFILLJES

Duke u nisur nga obligimi i paraparë me nenin 44 të Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo-arsimor, ministri i arsimit ka miratuar Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes,⁵³ me qëllim që të rregullohet më për së afërmi dhe me më shumë detaje „përmbajtja dhe mënyra e zbatimit të aktiviteteve parandaluese dhe intervenuese, kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të rrezikut, mënyrave të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja, përcjelljen e efektit të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra“. Me rregullore përpunohen më detajisht dispozitat e Ligjeve të cilat kanë përcaktuar kornizën e aktiviteteve të institucioneve edukativo arsimore në parandalim të mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna.

Rregullorja miraton përkufizimin e dhunës dhe keqtrajtimit të cilën e përcakton Ligji mbi bazat e sistemit edukativo arsimor⁵⁴, ndërsa më tej edhe i definon format e ndryshme të dhunës:

- Dhuna fizike është „sjellja e cila mund të sjell deri te lëndimi i vërtetë apo i mundshëm trupor i fëmijës, nxënësit apo të punësuarit; dënimi fizik i nxënësit dhe i fëmijës nga ana e të punësuarve dhe të rriturve“;
- Dhuna fizike „është sjellja e cila shpie deri te cenimi momental apo i përhershëm i shëndetit psikik dhe emocional dhe i dinjitetit të fëmijës dhe nxënësit apo të punësuarit“;
- Dhuna sociale dhe keqtrajtimi është „sjellja me të cilën përjashtohet fëmija dhe nxënësit nga grupi i bashkëmohatarëve dhe formave të ndryshme të aktiviteteve shoqërore, me ndarjen nga të tjerët, mos-pranimin për shkak të ndryshimit, mohimin e informatave, izolimin nga bashkësia, mohimin e përmbushjes së nevojave shoqërore“;
- Abuzimi i fëmijës dhe i nxënësit është „gjithçka që një individ, gjegjësisht një institucion bën apo nuk bën, e cila ndikon negativisht, sjell dëm, mohon apo ul mundësinë e për zhvillim të sigurte dhe të shëndoshë dhe e sjell në pozitë të pafuqishme ndaj individit apo institucionit (abuzim në sport, për qëllime politike, fetare, komerciale dhe të tjera). Abuzim nënkupton edhe nxitje të tepruar, gjegjësisht presion psikologjik ndaj fëmijës dhe nxënësit nga ana e prindërve apo nxënësve me qëllim të realizimit të arritjeve, i cili mund të ketë si pasojë cenimin e zhvillimit normal psikofizik dhe social dhe interesave më të mira të fëmijës“;

⁵³ „Kumtari zyrtar i RS-së“, nr. 30/2010

⁵⁴ „me dhunë dhe keqtrajtimit nënkuptohet çdo formë e sjelljes verbale apo joverbale të ushtruar njëherë apo të përsëritur e cila ka për pasojë cenimin e vërtetë apo të mundshëm të shëndetit, zhvillimit dhe dinjitetit të nxënësit apo të të punësuarit“

- Dhuna dhe abuzimi seksual është “sjellje me të cilën fëmija dhe nxënësi shqetësohen seksualisht, orientohet apo detyrohet në pjesëmarrje në aktivitete seksuale të cilat ai nuk i dëshiron, nuk i kupton apo për të cilat nuk është i përshtatëshëm për nga rritja apo në të cilat ai shfrytëzohet për prostitucion, pornografi apo format tjera të eksploatimit seksual”;
- Eksploatimi është „puna e cila nuk është në interesin më të mirë të fëmijës dhe nxënësit, ndërsa në dobi të personit, institucionit apo organizatës tjetër. Këto aktivitete mund të kenë si pasojë cenimin e shëndetit fizik apo mental, zhvillimin moral, shoqëror apo emocional të fëmijës dhe nxënësit, varësin e tij ekonomike, mohimin e të drejtës në arsim dhe liri të zgjedhjes“;
- Dhuna dhe abuzimi elektronik është „keqpërdorimi i teknologjisë informative e cila mund të ketë si pasojë lëndimin e ndonjë personaliteti tjetër dhe cenimin e dinjetetit dhe realizohet me dërgimin e porosive përmes postës elektronike, SMS-it, MMS-it, ueb faqes (ëeb site), bashkëbisedës (chat), kyçjen në forume, rrjete sociale, etj.“;
- Mospërfillja dhe sjellja mospërfillëse është „dështimi i prindit apo personit tjetër, institucionit apo të punësuarit, i cili ka marrë përsipër kujdesin për fëmijën dhe nxënësin që në kuadër të mjeteve në dispozicion të sigurojë kushte për zhvillim të rregullt të fëmijës dhe nxënësit në të gjitha lëmitë, e që mund të cenojë shëndetin dhe zhvillimin e tij. Mospërfillja në institucione përfshin; mos reagim ndaj dyshimit mbi mospërfillje apo mospërfillje nga ana e prindërve; dështimet në ushtrimin e mbikëqyrjes dhe mbrojtjes dhe fëmijës dhe nxënësit nga vetë-lëndimi, përdorimi i alkoolit, duhanit, mjeteve narkotike apo substancave psikoaktive, përfshirjes në grupe dhe organizatave destruktive dhe të tjera“.

Rregullore pastaj zbërthen në më shumë detaje aktivitetet e institucionit arsimor me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna. Përcaktimi i rregullave është i bazuar si në dispozitat e Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor, ashtu edhe në parimet dhe rregullat të cilat janë përcaktuar nga Protokollin i përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja dhe Protokollin special për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtim dhe mospërfillja në institucione edukativo-arsimore.

Shkolla në rend të parë ka obligim të zbatoj aktivitete parandaluese, qëllimet e të cilëve janë:

- Ngritja e nivelit të vetëdijes dhe ndjeshmërisë së fëmijës dhe nxënësit, prindit dhe të gjithë të punësuarve për të njohur dhunën, keqtrajtimin dhe mospërfilljen;
- Kultivimi i atmosferës së bashkëpunimit dhe tolerancës, respektit dhe komunikimit konstruktiv, nuk tolerohet dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Avancimi i dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për reagim konstruktiv ndaj dhunës; sigurimi i mbrojtjes së fëmijës dhe nxënësit, prindërve dhe të gjithë të punësuarve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja.

Aktivitetet parandaluese përfshijnë:

- Planifikimi (hartimi i Programit të mbrojtjes)

- Zbatimi adekuat i punës edukative me fëmijët dhe nxënësit
- Informimi i të gjithë të punësuarit, fëmijëve, nxënësit dhe prindërit mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre të parapara me ligj, me Rregulloren mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje me dhunën, keqtrajtimin dhe mospërfilljen dhe me akte të tjera nënligjore dhe të përgjithshme.

Në aktivitete parandaluese janë përfshirë të gjithë pjesëmarrësit e procesit arsimor: arsimtarët, punëtorët profesional, udhëheqësi i institucionit, organi drejtues, fëmijët/nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre.

Parandalimin e dhunës, keqtrajtimin dhe mospërfilljes është një aktivitet i planifikuar dhe njëri nga prioritetet në realizimin e punës edukativo-arsimore. Institucioni edukativo arsimor i planifikon këto veprimtari me miratimin e Planit vjetor të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja, i cili është pjesë përbërëse e planit vjetor të punës. Programi i mbrojtjes orienton masat dhe aktivitetet e domosdoshme për “krijim dhe kultivim të atmosferës pozitive dhe ambientit të sigurtë”. Përmbajtja e Programit të mbrojtjes është si në vijim:

- Mënyrën në të cilën masat dhe aktivitetet parandaluese sendërtohen në jetën dhe punën e përditshme të institucionit;
- Trajnimi profesional i të punësuarve me qëllim të avancimit të aftësive;
- Mënyrën e informimit mbi obligimet dhe përgjegjësitë në lëminë e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Nxitja dhe aftësimi i nxënësve për pjesëmarrje aktive në punën e bashkësisë klasore, parlamentit të nxënësve, këshillit të shkollës dhe organeve profesionale të institucionit; përmbajtjen dhe mënyrat për të forcuar punën edukative;
- Veprimet për njohje të hershme të rrezikut nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja; mënyrat e reagimit ndaj dhunës, keqtrajtim dhe mospërfillje, rolet dhe përgjegjësitë në veprim dhe intervenim kur ekziston dyshimi apo kur këto me të vërtetë ekzistojnë;
- Format dhe përmbajtja e punës me të gjithë fëmijët dhe nxënësit, gjegjësisht me ata të cilët pësojnë, kryejnë apo janë dëshmitarë të dhunës, keqtrajtimin dhe mospërfilljes;
- Mënyrat, format dhe përmbajtja e bashkëpunimit me familjen, njësinë e vetëqeverisjes lokale, qendrës për punë sociale, shërbimin shëndetësor, etj.;
- Mënyrat e përcjelljes, vlerësimit dhe raportimit.

Rregullorja mbi protokollin e veprimit në institucione në përgjigje të dhunës, keqtrajtimin dhe mospërfilljes parasheh që institucioni edukativo arsimor është i obliguar të themelojë Ekipin për mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja. Kjo, në fakt, është një prej aktiviteteve elementare parandaluese në lëminë e mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna. Përbërjen e Ekipit e përcakton drejtori i institucionit nga mesi i të punësuarve, ndërsa sipas nevojës mund të jenë të

përfshirë edhe përfaqësues të prindërve dhe bashkësisë lokale, parlamentit të nxënësve dhe ekspertët adekuat (punëtori social, pedagogu special, mjeku, përfaqësuesi i policisë, etj.)

Detyrat e Ekipit për mbrojtje janë si në vijim:

- Përgatitja e Programit të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Informimi i fëmijëve dhe nxënësve, të punësuarve dhe prindërve/kujdestarëve mbi aktivitetet e planifikuara dhe mundësitë për të kërkuar mbështetje dhe ndihmë nga Ekipi për mbrojtje;
- Pjesëmarrja në trajnime dhe projekte për zhvillimin e kompetencave të nevojshme për parandalimin e dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes;
- Propozimi i masave për parandalim dhe mbrojtje,
- Organizimi i konsultimeve
- Pjesëmarrje në proces të vlerësimit të rrezikut dhe marrjes së vendimit mbi veprimet në rast të dhunës apo informatave mbi dhunën, keqtrajtimin dhe mospërfilljen;
- Zbatimi i masave të intervenimit
- Përfshirja e prindërve/kujdestarëve në masat dhe aktivitetet parandaluese dhe intervenuese;
- Përcjellja dhe vlerësimi i efektit të masave të ndërmarrura për mbrojtje të fëmijëve dhe nxënësve dhe dhënia e propozimeve gjegjëse drejtorit;
- Bashkëpunimi me ekspertë të organeve, organizatave, shërbimeve dhe mediave të tjera kompetente për mbrojtje gjithëpërfshirës e të fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Mbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit;
- Raportimi i drejtorit të institucionit, organeve profesionale dhe organeve të administratës.

Disponueshmëria e informatës mbi ekzistimin e Ekipit është parakusht për realizimin e rolit të tij. Prandaj është obligimi i institucioneve që në mënyrë adekuate të njoftojë fëmijët, nxënësit, të punësuarit, prindërit/kujdestarët mbi ekzistimin e Ekipit dhe anëtarëve të tij.

Në rastet kur është paraqitur dhuna apo është duke u zhvilluar, institucioni edukativo arsimor ndërmerr aktivitete intervenuese dhe masat mbështetëse. Veprimet e institucionit varen nga niveli i dhunës: Rregullorja, në fakt, ndan dhunën në tre nivele. Kjo ndarje ka për qëllim që të sigurojë “veprime (intervenim) të njësuar të institucioneve në situata të dhunës dhe keqtrajtimit kur akterët janë fëmijë, gjegjësisht nxënës (fëmijë – fëmijë, nxënës – nxënës, fëmijë dhe nxënës – i punësuar)“.

Varësisht prej nivelit të dhunës orientohen edhe aktivitetet dhe masat e mbështetjes:

Dhuna e shkallës së parë kërkon angazhim të pavarur “të kujdestarit të klasës, arsimtarit, gjegjësisht edukatorit, në bashkëpunim me prindin, në kuptim të punës së intensifikuar edukative me grupin edukativ, bashkësinë klasore, grupin e nxënësve dhe individualisht“.

Niveli i dytë i dhunës kërkon punë të forcuar edukative – aktivitete të cilat i ndërmerr kujdestari i klasës, gjegjësisht edukatori, në bashkëpunim me pedagogun, psikologun, Ekipin për mbrojtje dhe drejtorin, me

pjesëmarrje obligative të prindërve. Nëse puna e forcuar edukative nuk është efektiv, drejtori inicion procedurë edukativo-disiplinore dhe shqipton masën, në përputhje me Ligjin.

Dhuna e nivelit të tretë kërkon punë intensive edukative – aktivitetet e drejtorit me Ekipin për mbrojtje, me angazhimin e obligueshëm të prindërve dhe organeve, organizatave dhe shërbimeve kompetente (qendra për punë sociale, shërbimi shëndetësor, policia dhe organizatat dhe shërbimet e tjera). Në këtë nivel, e obligueshme është puna edukative e cila është e përshtatur nevojës së nxënësve, si dhe inicimi i procedurës edukativo-disiplinore dhe shqiptimit të masës, në përputhje me Ligjin. Nëse për punë me nxënësin është angazhuar edhe ndonjë organizatë apo shërbim tjetër, institucioni vendos bashkëpunim me të dhe koordinon aktivitetet në mënyrë të ndërsjellë. Tek niveli i tretë i dhunës, institucioni është i obliguar që për ndodhinë të njoftojë Ministrinë për arsim dhe shkencë – udhëheqjen kompetente të shkollës, në afat prej 24 orëve.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve intervenuese, institucioni arsimor ka obligime të veçanta në rastet kur ngjarja kërkon intervenim të menjëhershëm; institucioni është i obliguar që në aktivitetet e veta të përfshijë edhe qendrën për punë sociale, si dhe organet e gjyqësisë si dhe policinë, nëse ngjarja ka elemente të veprës penale, gjegjësisht kundërvajtjes.

Veprimet e mbrojtjes së fëmijëve në institucione arsimore duhet të udhëhiqen në mënyrë efikase dhe ekonomike, me sigurimin e mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave. Në veçanti duhet të sigurohet që fëmija/nxënësi të mos iu nënshtrohen dhënies së përsëritur të deklaratave.

Në zbatimin e aktiviteteve intervenuese, institucionet e arsimit do të ndërmarrin hapat vijuese dhe atë me renditje të paraparë:

- 1) Shqyrton dyshimet apo zbulon dhunën, keqtrajtimet dhe mospërfilljet
- 2) Ndalimi i dhunës dhe keqtrajtimet dhe qetësimin e nxënësve
- 3) Njoftimi i prindërve dhe ndërmarrja e veprimeve urgjente sipas nevojës
- 4) Konsultimet në institucione; në këtë fazë të procedurës, mund të përfshihen edhe organet dhe institucionet tjera (Ministria e arsimit dhe shkencës – drejtoria e shkollës, qendra për punë sociale, policia, shërbimi shëndetësor, etj.)
- 5) Hartimi i Planit operativ të mbrojtjes, i cili përmban:
 - Aktivitetet e orientuara kah ndryshimi i sjelljes – punë të intensifikuar edukative, puna me prindërit, punë me bashkësinë klasore, përfshirjen e parlamentit të nxënësve dhe këshillit të prindërve, ndërsa sipas nevojës edhe organeve drejtuese;
 - Bartësit e aktiviteteve
 - Afati i përfundimit të aktivitetit
 - Mënyrat me të cilat sigurohet përfshirja e serishme e të gjithë pjesëmarrësve në dhunë, keqtrajtim dhe mospërfillje në bashkësi.

Planin e mbrojtjes e harton Ekipi për mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në mënyrë të pavarur (apo sipas nevojës) me përfshirje të organeve, shërbimeve dhe institucioneve të tjera. Në përgatitje të planit të mbrojtjes, sa herë që është e mundur, institucioni përfshin përfaqësues të bashkësisë klasore, gjegjësisht grupet, si dhe parlamentin e nxënësve.

6) Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve sipas Planit operativ të mbrojtjes:

Masat dhe aktivitetet duhet të jenë të ndërmarrura me pjesëmarrje të fëmijës dhe nxënësit dhe të jenë në përputhje me mundësitë zhvillimore të tij. Kur Ekipi për mbrojtje vlerëson se ekziston nevoja, propozon hartimin e planit individual arsimor.

7) Përcjellja e efekteve të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.

Institucioni edukativo arsimor përcjell realizimin e Planit vjetor të mbrojtjes. Për këtë qëllim, evidentohen të gjitha rastet e dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes së nivelit të dytë dhe të tretë dhe përcjell realizimin e planeve konkrete të mbrojtjes. Ekipi për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja i raporton drejtorit të institucionit dy herë në vit lidhur me të dhënat e grumbulluara dhe vlerësimet e nxjerrura, ndërsa drejtori njofton organin drejtues, Këshillin e prindërve dhe Parlamentin e nxënësve.

Raporti mbi realizimin e programit të mbrojtjes është një pjesë përbërëse e raportit vjetor mbi punën e institucionit dhe i parashtrohet Ministrisë së arsimit, gjegjësisht drejtorisë kompetente të shkollës.

Edhe pse Ligji mbi bazat e sistemit edukativo arsimor ka hyrë në fuqi para më shumë se dy viteve, aktet nënligjore me të cilat rregullohen kriteret për njohjen e formave të diskriminimit nga ana e të punësuarve, nxënësve dhe palëve të tjera në institucione dhe aktet nënligjore me të cilin rregullohen kushtet e hollësishme mbi mënyrën e njohjes së formave jo-verbale të keqtrajtimit të fëmijëve dhe nxënësve nga ana e të punësuarve gjatë orarit të kujdesit, pushimit dhe rekreacionit si dhe formave të tjera të punës edukativo-arsimore, nuk janë miratuar. Me ndryshimet e Ligjit mbi bazat e sistemit edukativo arsimor, të cilat janë botuar në „Kumtarin Zyrtar të RS-së“, nr. 52/11, është vazhduar afati për miratimin e këtyre akteve nënligjore, prej dy në tre vite nga dita e Hyrjes së ligjit në fuqi.

PROTOKOLLI I PËRGJITHSHËM PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DHUNA DHE MOSPËRFILLJA

Duke realizuar një prej qëllimeve specifike të Parkut nacional të veprimit për fëmijë, Qeveria e Republikës së Serbisë ka sjellë në vitin 2005 Protokollin e përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja. Qëllimet themelore të Protokollit të përgjithshëm janë “avancimi i mirëqenies së fëmijëve përmes parandalimit të keqtrajtimit dhe mospërfilljes” dhe “kujdesi që të gjitha procedurat dhe vendimet, gjatë tërë procesit, të jenë në interesin më të mirë të fëmijës “. Protokollin e përgjithshëm jep përcaktim më të afërt të keqtrajtimit (keqtrajtimit dhe mospërfilljes) së fëmijëve: “Keqtrajtimi apo abuzimi i fëmijës përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik ose emocional, abuzim seksual, mospërfillje apo veprim të pakujdesshëm, si dhe eksploatim komercial dhe tjetër, gjë që sjell deri të cenimi i vërtetë apo potencial të shëndetit të fëmijës, cenimin e zhvillimit dhe dinjitetit të fëmijës

në kuadër të marrëdhënies e cila përfshin përgjegjësi, besim apo pushtet“. Ky përkufizim i përgjithshëm i dhunës dhe formave të saj individuale është e bazuar në përkufizimet të cilat janë të miratuara në Konsultimin mbi parandalimin e keqpërdorimit e fëmijëve në Organizatën botërore të shëndetësisë në Gjenevë, në vitin 1999 (përkufizim i dhunës nga Organizata botërore e shëndetësisë)⁵⁵. Protokollin e përgjithshëm definojnë edhe format individual të dhunës: keqtrajtimit fizik, keqtrajtimit seksual, keqtrajtimit emocional, mospërfilljen dhe sjellje mospërfillëse dhe eksploatim.

Duke u nisur nga katër parimet udhëheqëse të Konventës për të drejtat e fëmijës, Protokollin e përgjithshëm përcakton si qëllime specifike „informimin e ekspertëve të cilët punojnë me fëmijë, si dhe opinionin e gjerë, përfshirë edhe fëmijët, si të veprohet në rast të dyshimit se fëmija është viktimë e keqtrajtimit dhe e mospërfilljes apo që mund të bëhet i tillë “ „vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet ekspertëve nga të gjitha lëmitë e cila është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijëve” dhe “themelimin e procedurës efikase dhe operative e cila do të sigurojë që kur keqtrajtimi dhe mospërfillja të ndodh, të ekzistojë procedurë e shpejtë dhe e koordinuar e cila mbron fëmijët nga keqtrajtimi dhe siguron ndihmë gjegjëse fëmijës dhe familjes “. Me qëllim të realizimit të rrjetit operativ dhe efikas shumë-disiplinor për mbrojtjen e fëmijëve, si një prej qëllimeve Protokollin e përgjithshëm e përcakton edhe miratimin e protokolleve speciale në sistemet e mbrojtjes sociale dhe familjare-juridike, të punëve të brendshme, shëndetësisë dhe arsimimit. Me protokolle speciale hartohen procedurat interne në çdonjërin prej këtyre sistemeve, në përputhje me parimet dhe qëllimet e Protokollit të përgjithshëm. Me Protokollin e përgjithshëm Ministrinë obligohet që të nxisin miratimin e rregullave dhe procedurave të brendshme në kuadër të organeve dhe institucioneve, si dhe lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunim në nivel lokal. Gjithashtu është obligim i ministrive që të sigurojnë trajnimin sistematik të ekspertëve, e cila përfshin: edukimin elementar (dedikuar të gjithë të punësuarve në institucione dhe organizata të tjera të cilat merren me fëmijë); nivelin më të lartë arsimor (dedikuar ekspertëve (ekipeve të ekspertëve) të cilat merren drejtëpërsdrejti me mbrojtjen e fëmijëve në lëmi të caktuara), dhe edukimin e specializuar (dedikuar numrit të caktuar të ekspertëve të shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes sociale, gjyqësorit dhe policisë, në mënyrë që të fitojnë dije dhe shkathtësi të specializuara).

Protokollin e përgjithshëm përcakton kornizat bazë të veprimeve të institucioneve në rast të dyshimit apo njohurive për dhunën, keqtrajtimit dhe/ose mospërfilljen e fëmijës; ky proces përfshin njohjen e rasteve të keqtrajtimit dhe/ose mospërfilljes; raportimin organeve, gjegjësisht shërbimit kompetent; vlerësimin e rrezikut, gjendjes dhe nevojave të fëmijës dhe familjes si dhe planifikimi i shërbimeve dhe masave për mbrojtjen e fëmijës. Në veçanti theksohet se të punësuarit në organe dhe institucione (siç janë ato arsimore apo shëndetësore), mund të jenë persona të besueshëm të fëmijës, viktimës apo personat të cilët kanë informata të para mbi dhunën (kërcënues) ndaj fëmijës, dhe prandaj janë në obligim që pa vonesë të veprojnë sipas rregullave të cilat i përcakton Protokollin e përgjithshëm dhe në bazë të tyre të miratojnë protokolle speciale.

PROTOKOLLI SPECIAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE NXËNËSVE NGA DHUNA, KEQTRAJTIMI DHE MOSPËRFILLJA NË INSTITUCIONE EDUKATIVO-ARSIMORE

⁵⁵ <http://www.yesican.org/definitions/WHO.html>

Në përputhje me parimet dhe qëllimet e parapara me Planin kombëtar të veprimit për fëmijët dhe me Protokollin e përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja, Ministria për arsim dhe shkencë në vitin 2007 ka miratuar Protokollin special për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo-arsimore. Protokollin përpunon "aktivitetet parandaluese dhe procedura të definuara në mbrojtje të fëmijëve nga dhuna, me të cilat precizohet roli i të gjithëve që janë të kyçur në jetë dhe në punën e institucionit edukativo-arsimor", dhe iu është dedikuar udhëheqësve dhe nëpunësve të institucioneve edukativo-arsimore, por edhe fëmijëve/nxënësve, prindërve/kujdestarëve, përfaqësuesve të bashkësisë lokale dhe të gjitha institucioneve të cilat mund të jenë kyçur në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.

Ashtu si edhe Protokollin e përgjithshëm, Protokollin special shpall dhunën ndaj fëmijës si shkelje të të drejtave të fëmijës në jetë, mbijetesë dhe zhvillim. Protokollin definon dhunë si "çfarëdo formë të sjelljes verbale apo joverbale të kryer njëherë apo të përsëritur e cila ka për pasojë rrezikimin e vërtetë apo të mundshëm të shëndetit, zhvillimit dhe dinjitetit të fëmijës/nxënësit", pa marrë parasysh se në cilën formë paraqitet dhuna (fizike, emocionale/psikologjike, dhuna dhe abuzimi seksual, dhuna me aplikimin e teknologjisë informative (dhuna elektronike), keqpërdorimi i fëmijëve/nxënësve, mospërfillja dhe sjellja mospërfillëse, eksploatimi).

Protokollin special përpunon procedurën interne të institucionit edukativo arsimor në rastet e dyshimit/njohurive mbi dhunën, keqtrajtimin dhe mospërfilljen dhe njëkohësisht jep kornizën për planifikimin e aktiviteteve parandaluese. Protokollin është "obligativ për të gjithë të cilët marrin pjesë në jetën dhe punën e institucionit edukativo-arsimor", ndërsa institucionet janë në obligim që në programet e tyre vjetore të definojnë Programin e mbrojtjes së fëmijëve/nxënësve nga dhuna dhe të formojnë ekipe për mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve nga dhuna.

Parimi themelor i Protokollit special është që institucionet edukativo arsimore duhet të krijojnë një klimë ku...dhuna nuk tolerohet; për dhunën nuk ka heshtje" dhe në të cilën „cili do që ka informata për dhunën është i obliguar të veprojë“. Veprimi i institucioneve është i dyfishtë: parandalues (përmes masave të parandalimit) dhe mbrojtës (përmes masave të intervenimit dhe mbështetjes). Masat e parandalimit janë të orientuara kah krijimi i një klime jo të dhunshme në institucion, përfshirjen e të gjithëve në parandalim të dhunës, krijimin e programit për parandalim të dhunës, ngritjen e nivelit të vetëdijes mbi njohjen e dhunës, definimin e procedurave të mbrojtjes nga dhuna, informimin e të gjithë personave të kyçur në jetën dhe punën e institucionit për procedurat dhe veprimet për mbrojtjen nga dhuna dhe reagimi në situatat e dhunës, avancimit të dijeve së të punësuarve, fëmijëve, nxënësve, prindërve, kujdestarëve dhe të tjerëve për të njohur dhe reaguar në rastet e dhunës. Masat e intervenimit gjegjësisht të mbështetjes janë të orientuar kah krijimi i sistemit të mbrojtjes, përcjelljes dhe evidentimit efikas të dhunës, vlerësimin e programit ekzistues të mbrojtjes nga dhuna, zbutjes/mënjanimit të pasojave të dhunës së pësuar, punës këshilluese me fëmijët të cilët vuajnë nga dhuna dhe fëmijët të cilët janë vërtetues të dhunës. Hapat të cilat i parasheh Protokollin special janë obligues.

Obligimi i veçantë i institucioneve edukativo arsimore të cilat rrjedhin nga Protokollin special është formimi i ekupeve për mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve nga dhuna. Protokollin jep udhëzime vijuese obligative lidhur me këtë organ:

- Ekipin e formon udhëheqësi i institucionit (drejtori); numri i anëtarëve dhe përbërja varen nga specifikat e institucionit;
- Anëtarët e Ekipit duhet të shfaqin profesionalizëm të lartë në punë, shkathtësi të mira komunikimi, si dhe që në biografinë e vet personale dhe profesionale të mos ketë elemente të sjelljes së dhunshme;
- Të gjithë në institucion (të punësuarit, fëmijët/nxënësit dhe prindërit/kujdestarët) duhet të jenë të informuar që ekziston Ekipi dhe kush janë anëtarët e tyre; kjo informatë duhet të jetë e theksuar në vend të dukshëm;
- Organizimi i punës së Ekipit dhe koha se kur janë të obliguar të ndërmarrin masa duhet të jenë në përputhje me orarin e punës të institucionit, ashtu që gjatë orarit të punës së institucionit disa nga anëtarët e Ekipit të jenë në dispozicion;

Detyrat e anëtarëve të Ekipit për mbrojtje të fëmijëve/nxënësve nga dhuna janë të:

- Marrin pjesë në mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Informojnë dhe të ofrojnë trajnim elementar për të gjithë të punësuarit në institucion me qëllim të arritjes së dijes dhe shkathtësive minimale për parandalimin, njohjen, vlerësimin dhe reagimin ndaj dukurisë së dhunës, keqtrajtimit dhe mospërfilljes së fëmijës/nxënësve;
- Organizojnë njohjen e fëmijëve/nxënësve, prindërve/kujdestarëve dhe bashkësisë lokale me Protokollin e përgjithshëm dhe special për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe mospërfillja;
- Koordinojnë hartimin dhe realizimin e programit të mbrojtjes së fëmijëve/nxënësve nga dhuna;
- Zbatojnë aktivitete parandaluese dhe intervenuese dhe ndërmarrin masa mbështetëse;
- Organizojnë konsultime në institucion dhe vlerësojnë nivelin e rrezikut për sigurinë e fëmijëve/nxënësve;
- Monitorojnë dhe vlerëson efektin e masave të ndërmarra në mbrojtje të fëmijëve/nxënësve;
- Bashkëpunojnë me institucionet relevante;
- Përgatisin planet e paraqitjes së institucioneve para publikut dhe mediave;
- Organizojnë evidentimin e dukurisë së dhunës;
- Grumbullojnë dokumentacionin;
- Raportojnë organeve profesionale dhe atyre udhëheqëse.

Ministria e arsimit dhe shkencës në vitin 2009 ka botuar Doracakun për zbatimin e protokollit special për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi dhe mospërfillja në institucionet edukativo-arsimore, me qëllim që të punësuarit në shkolla të marrin informata më të detajshme dhe konkrete mbi mënyrën se si do të zbatohen masat e parandalimit dhe mbrojtjes së nxënësve nga dhuna.

CIP – Katalogimi në botimet, Biblioteka kombëtare e Serbisë, Beograd

343.59:373(497.11)342.726-057.874(497.11)

NEŠIĆ, Snežana

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në shkolla: Raporti i Mbrojtësit të qytetarëve dhe Panelit të këshilltarëve të rinj/ [Snežana Nešić, Nataša Jović]. - Beograd: Mbrojtësi i qytetarëve, 2011 (Beograd :Interprint). - 64 str. : ilustr. ; 30 cm

Tirazhi 250. – Vërejtje dhe literatura në tekst.

ISBN 978-86-87945-10-4 1. Jović, Nataša [autore) Dhuna në shkolla - Hulumtimi - Srbijab) Viktimat e dhunës – Fëmijët – Mbrojta ligjore - Serbia.SR-ID 188025356